14 SULME NDAJ GAZETARËVE - 14 THERJE NDAJ DEMOKRACISË

Prill 2021

Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë

Redaktor: Dragan Sekulovski

Autorët: Sunai Sabrioski
Kristina Atovska

Ky botim është përgatitur me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e vetme e Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se reflekton pikëpamjet e Bashkimit Evropian ose Fondit Evropian për Demokraci

PËRMBAJTJA

I. PARATHËNIE 3

II. SULMET NDAJ GAZETARËVE JANË SULME NDAJ DEMOKRACISË 5

III. GAZETARËT PËR SULMET DHE KËRCËNIMET: U MËSUAM MË, DHE KJO NUK ËSHTË NJË GJË PËR TU KRENUAR 13

IV. STANDARDE TË DYFISHTA KUR BËHET FJALË PËR SHKELJEN E SIGURISË SË GAZETARËVE KUNDREJT POLITIKANËVE 16

V. PRAKTIKA GJYQËSORE DHE EFIKASITETI NË MBROJTJEN E GAZETARËVE 21

VI. INSTITUCIONET DHE GAZETARËT 33

VII. QËNDRIM INTEGRAL I MPB-SË NË LIDHJE ME SULMET NDAJ GAZETARËVE DHE PUNONJËSVE MEDIATIK 36

VIII. QËNDRIMI INTEGRAL I PTHP NË LIDHJE ME SULMET NDAJ GAZETARËVE DHE PUNONJËSVE MEDIATIK 38

IX. REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIMIN E SITUATËS 39

I. PARATHËNIE

Liria e fjalës, paraqitja publike, informimi publik kundrejt sigurisë së gazetarëve janë tema të lidhura ngushtë në mes tyre, të cilat depërtojnë në poret më të rëndësishme të gazetarisë. Ato, në fakt, pasqyrojnë pjekurinë e një shoqërie dhe një demokracie për të luftuar me sfidat me të cilat përballet gazetaria sot. Sfidat kryesore, të cilat ekzistojnë prej vitesh, janë gjendja e dobët ekonomike e një pjesë të gazetarëve, por edhe presioni financiar mbi disa media nga qendrat e ndryshme të fuqisë, politike dhe të biznesit, si dhe përpjekjet për të ndikuar mbi gazetarinë në një mënyrë brutale, përmes kërcënimeve për sigurinë e gazetarëve. Ky segment i dytë i këtyre dy elementeve kryesorë që përfaqësojnë punën e gazetarëve është objekt i vëzhgimit tonë në këtë botim, si dokument për një kohë, që do të dëshmojë qëndrimin e institucioneve ndaj këtij problemi përballë sakrificës së madhe që bëjnë gazetarët në luftën me armiqtë e dukshëm dhe të padukshëm.

Siguria e gazetarëve dhe punonjësve mediatik është një ndër parakushtet themelore për kryerjen e detyrave profesionale gazetareske dhe për informimin objektiv dhe në kohë të qytetarëve. Garantimi i sigurisë së ekipeve gazetareske demonstron gjithashtu edhe kapacitetin demokratik të një shoqërie sepse u në këtë mënyrë i lihet hapësirë gazetarëve që të ushtrojnë lirshëm profesionin e tyre në mënyrë që të kënaqin interesin publik. Pikërisht për shkak të këtyre arsyeve, çështjet e sigurisë së gazetarëve janë një nga treguesit themelorë me të cilët merret Komisioni Evropian kur monitoron vendet që kanë statusin e vendeve kandidate për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Kështu, raportet vjetore të Komisionit Evropian në Kapitullin 23, të cilat i referohen gjyqësorit dhe të drejtave të njeriut, përveç shkallës së lirisë

së shprehjes, ofrojnë edhe kualifikime në kontekstin e sigurisë së gazetarëve dhe punonjësve mediatik, si dhe politika e mosndëshkimit në rastet e shkeljes së të drejtave të tyre.

Qëndrimi i shtetit ndaj këtij problemi është një nga treguesit kryesorë, i cili ndihmon për të përcaktuar vendin si të lirë, pjesërisht të lirë ose jo të lirë. Rritja e vendit në shkallën që mat lirinë e fjalës, përveç disa faktorëve të tjerë, determinohet me qëndrimin e institucioneve shtetërore (MPB, Prokuroria Publike, gjykatat) dhe aktorëve socialë (Qeveria, partitë politike, OJQ-të, publiku) ndaj këtij problemi. Jo vetëm në aspektin e (mos) ndëshkimit për këto akte, por edhe përmes krijimit të një klime të përgjithshme që stimulon ose dekurajon akte të tilla kundër gazetarëve dhe punonjësve mediatik. Shoqëria maqedonase ende është e ndarë. Bipolariteti i skenës politike, injoranca politike, fjalimi publik, i cili shpesh krijon një klimë urrejtjeje, beteja e pamëshirshme në rrjetet sociale midis kundërshtarëve partiak, janë akoma terren pjellor që gazetarët të jenë shënjestër e kërcënimeve verbale dhe fyerjeve, por gjithashtu edhe sulme fizike dhe kërcënime serioze ndaj sigurisë së tyre.

Kjo, gjatë vitit të kaluar, ishte e përkeqësuar me ndihmën e disa faktorëve të tjerë:

- Pandemia, si globalisht ashtu edhe në nivel lokal, ka kontribuar në ndarje të ndryshme midis qytetarëve, me narrative publike, kryesisht në mediat sociale, por edhe në mediat tradicionale, duke justifikuar ose duke i dënuar masat për parandalimin e virusit Kovid-19;
- Zgjedhjet e parakohshme parlamentare, në shumë raste, kanë kontribuar në rritjen e retorikës së ashpër ndaj gazetarëve, veçanërisht në rrjetet sociale;
- Temat në lidhje me çështjet bilaterale midis Maqedonisë dhe Bullgarisë, gjithashtu, kontribuuan në kthimin e temave si "tradhtarë dhe patriotë", dhe këtu përsëri në një segment vuajtën gazetarët.
- Vendimi për regjistrimin ishte dhe ende është një temë e nxehtë politike, mbi të cilën "ushtarët" partiak ose aktivistët, të inkurajuar nga selitë e tyre partiake, gjeneruan zemërim të fortë tek publiku, i cili kontribuon për fjalime të ashpra kundër gazetarëve dhe punonjësve mediatik.

Duke pasur parasysh kulturën e ulët politike në transmetimin e informatave dhe debatit politik nga pothuajse të gjitha subjektet politike, e cila është e pranishme në sektorin e medias, por edhe për shkak të ndjeshmërisë së këtyre çështjeve, shpesh janë vërejtur fjalime dhe deklarata agresive me elementë të kërcënimeve ndaj sigurisë së gazetarëve, jo vetëm në mediat sociale, por edhe në mediat tradicionale. Kështu, në vitin 2020, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM), organizata e vetme që mban një regjistër për sulmet dhe kërcënimet ndaj gazetarëve, sipas një metodologjie të harmonizuar në bashkëpunim me pesë shoqata të tjera nga vendet e tjera të Ballkanit, këtë vit regjistron më shumë sulme ndaj gazetarëve krahasuar me vitet e mëparshme. Sipas këtij regjistri, në vitin 2020, u shënuan gjithsej 14 kërcënime serioze ndaj sigurisë së

gazetarëve dhe punonjësve mediatik, nga të cilat më shumë se gjysma ishin kundër gazetareve, krahasuar me vitin e kaluar, ku kishte vetëm katër sulme ose kërcënime kundër gazetarëve, që vjen si rezultat i mizogjinisë së theksuar në shoqërinë tonë. Me rritjen e përdorimit të platformave digjitale, gazetaret përballen me rrezik të zmadhuar gjatë kryerjes së punës së tyre dhe gjithnjë e më shpesh me sulme seksiste. Në sferën e internetit janë vërejtur mjaft shembuj të kërcënimeve, shantazheve, gjuhës së urrejtjes dhe dezinformimeve kundër gazetareve të caktuar. Mizogjinia, e kombinuar me dhunën në internet, është një kërcënim real për pjesëmarrjen e grave në gazetari dhe në komunikimin publik në epokën digjitale.

Gjithashtu, në lidhje me numrin e përgjithshëm të sulmeve, duhet të merret parasysh se ky nuk është numri real i sulmeve, i cili supozohet të jetë më i lartë, por për arsye që lidhen me mosndëshkimin, frikën nga hakmarrja ose presionin shtesë nga ana e kërcënuesit ose ndoshta punëdhënësit në këtë sektor, viktimat shpesh herë zgjedhin të mos i paraqesin sulmet në institucionet ose organizatat përkatëse.

Problemi kryesor, megjithatë, mbetet trendi në rritje i mosndëshkimit në vitin 2020. Nga gjithsej 14 kërcënimesh ndaj jetës së gazetarëve, vetëm një rast përfundoi me vendim gjyqësor, ku kërcënuesi u dënua me burg.

II. SULMET NDAJ GAZETARËVE JANË SULME NDAJ DEMOKRACISË

Liria e shprehjes dhe liria e mediave janë gurrëthemeli i një shoqërie demokratike. Filozofi britanik **Xhon Stjuart Mill** e quajti lirinë e shtypit "një nga garancitë kundër një qeverie të korruptuar dhe tirane" ("Për Lirinë" viti 1859). Që një shtet të mund të proklamojë veten si shtet demokratik, është e nevojshme të garantojë sigurinë e gazetarëve dhe punonjësve mediatik, në mënyrë që të ketë media të pavarur dhe profesionale. Në vend, në vitin 2020, janë regjistruar gjithsej 14 sulme mbi gazetarët, pra mbi shtyllën e katërt - gazetarët, ato janë evidentuar nga Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë.

Rasti i parë i sulmit ndaj gazetarëve u shfaq në publik më pak se dy javë pas fillimit të vitit 2020. Sulmi është i regjistruar më 11.01.2020. Autori i sulmit është një punonjës shtetëror i punësuar në Regjistrin Qendror, **Emil Jakimovski**. Sulmi është mbi gazetaren **Meri Jordanovska**. Pikërisht një vit më parë, në orën 5 të mëngjesit, Jordanovska mori kërcënimin e parë përmes aplikacionit Telegram, në të cilin gazetarja paraqitet me identitetin e saj. "Ti po komunikon me amerikanët, kjo është arsyeja pse e përdor Telegramin, rrospi", thuhet në mesazhin që ka vendosur t'ia dërgojë anëtari i partisë më të madhe opozitare VMRO-DPMNE, Emil Jakimovski, i cili në atë kohë kishte rolin e zëdhënësit në Regjistrin Qendror të Maqedonisë. Mesazhi ishte i dedikuar pikërisht marrësit të informacionit, ose Meri Jordanovska, gazetare dhe zëvendës redaktore e portalit "A1 On". Sidoqoftë, Jakimovski nuk ishte i kënaqur vetëm me këtë mesazh, por sërish i është drejtuar viktimës, duke dërguar mesazhe fyese dhe kërcënuese: "Patë", "rrospi propagandistike", "ty duhet të ta shënojnë emrin në nekrolog", ishin disa nga mesazhet e dërguara tek gazetarja.

> *"Disa do të thonë pse nuk i injorove mesazhet. Unë nuk i injorova, sepse nuk kam dashur. Nuk dua dhe nuk do t'i injoroj kurrë fyerjet dhe sulmet, sepse nesër ato mund t'i ndodhin dikujt tjetër. Unë me mirësjellje i kërkova që të mos më shkruajë më, por kjo nuk ndodhi, kështu që këto ofendime u kthyen në kërcënime, deri në atë pikë sa unë u frikësova seriozisht, veçanërisht pasi ai më shkroi se jeton në ndërtesën tjetër dhe se ai e di saktësisht ku unë jetoj. Kërcënimet arritën në pikën që Jakimovski më shkroi se do të shkoj në burg, se do të më shkruajnë emrin në nekrolog, etj."* - thotë Meri Jordanovska.

Rasti i gazetares Meri Jordanovska tronditi publikun. Pasi gazetarja zbuloi fotografi nga "biseda" e ashtuquajtur me Jakimovskin në Facebook. Pas reagimeve të forta nga publiku, pasoi edhe përgjigjja nga autoritetet përkatëse.

> *"Unë u drejtova saktësisht kujt dhe ku ta raportoja rastin, në Njësinë e Krimit të Dhunshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ku autoritetet vepruan në mënyrën më profesionale dhe nuk mund të jap asnjë vërejtje të vetme në lidhje me punën e tyre. Më është shpjeguar saktësisht dhe në detaje se cilat janë të drejtat e mia, cilat janë kompetencat ligjore dhe çfarë do të ndërmerret në lidhje me rastin",* thotë Jordanovska.

Në ndërkohë, "oreksi seksist" i nëpunësit civil Emil Jakimovski u rrit edhe në vetë institucionin ku ai ishte i punësuar. Të nesërmen, viktima e shënjestruar e Jakimovskit zbuloi rastin e dytë, i cili është regjistruar në analet e Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë si sulm i dytë ndaj gazetarëve. Më 12.01.2020, gazetarja dhe redaktorja e Alfa TV, Iskra Koroveshovska, njoftoi se ajo ishte gjithashtu viktimë e sulmeve nga Emil Jakimovski. "E sheh se çfarë do të ndohë kur do të më takosh jashtë," ka thënë Jakimovski në një mesazh që ia ka dërguar gazetares **Iskra Koroveshovska**. Sot, një vit më vonë, Koroveshovska, duke kujtuar ngjarjen, shpjegon se Jakimovski kishte një qëllim të përcaktuar qartë: të shkelte dinjitetin e saj si gazetare, si njeri dhe si grua. Ajo ka paraqitur ngjarjen personalisht, por në të njëjtën kohë kanë reaguar shërbimet në sektorin për krimin kompjuterik dhe veprime të ngjashme në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

"Në disa raste mora kërcënime nga Emil Jakimovski, por, përveç mesazheve private, ai gjithashtu postoi statuse me përmbajtje fyese me qëllim që të shkatërrojë reputacionin tim," tha Iskra Koroveshovska.

Rastet e sulmeve ndaj gazetareve Jordanovska dhe Koroveshovska hyjnë në kronologji në regjistrin e historisë së sulmeve ndaj profesionit gazetaresk. Ditën e ardhshme, ndodh edhe një sulm i ri ndaj gazetarëve. Përsëri, shënjestra e sulmit është një grua gazetare. Sipas të dhënave të SHGM-së, sulmi është regjistruar më 13.01.2020 dhe i referohet gazetares në TV Telma, **Natasha Stojanovska,** e cila ka qenë e njohur për publikun në dy vitet e fundit edhe për shkak të raportimit të saj nga rasti i 27 prillit.

Në rastin konkret, Stojanovska ishte subjekt i sulmeve verbale përmes rrjeteve sociale. Duke kujtuar sulmet, Stojanovska tregon se shumica e sulmeve vijnë kur një nga liderët e partive politike është mysafir në emision. Në një nga rastet, gazetarja Stojanovska vendosi të paraqet kërcënimin në Ministrinë e Punëve Brendshme. Vendimi është ende në pritje. Në një rast tjetër, ajo personalisht iu është drejtuar burrit që qëndronte pas profilit të rremë. Përgjigja që ajo mori ishte se atij nuk i pëlqente emisioni që ajo po drejtonte dhe kjo ka qenë arsyeja pse ai ka shpikur atë që ka shkruar, në përpjekje për ta diskreditуar gazetaren personalisht.

"Disa nga sulmet vijnë menjëherë pas emisionit, disa nëse postoj tekst në profilin tim në Facebook, të shkruar nga ndonjë koleg, por dikujt nuk i pëlqen, disa vijnë kur postoj diçka për ngjarjet e 27 prillit. Unë nuk do të merresha me asnjë prej tyre individualisht, sepse ka shumë, dhe është e qartë se sulmet vijnë ose nga selitë e partive politike, dhe këto zakonisht janë profile të rreme në rrjetet sociale, dhe një pjesë më e vogël janë nga profilet reale në rrjetet sociale. Këto janë zakonisht njerëz që shohin idhuj tek politikanët dhe ato madje nuk frikohen të bëjnë një kërcënim të hapur, ndoshta duke menduar se ata janë të mbrojtur," tha Stojanovska.

Pesë ditë më vonë, më 18.01.2020, viktima e ardhshme - një gazetare merr mesazh në rrjetin social Facebook: "Ti je një turp për popullin maqedonas që duhesh ta ndryshosh fenë, po ti nuk ke faj, unë duheshe të të vras përderisa ishit në Gazela". Dërguesi është regjistruar me pseudonimin Ivo Bucim, ndërsa marrësi i këtij mesazhi me elementë kërcënuese është gazetarja **Aneta Dodevska** nga TV 24. Rasti përmes Shoqatës së Gazetarëve është regjistruar në Ministrinë e Punëve të Brendshme, por gazetarja nuk ka marrë ndonjë përgjigje nga institucionet kompetente deri në shkrimin e këtij teksti. Në ndërkohë, përderisa priste përgjigje nga autoritetet - i njëjti person, pas paraqitjes së rastit në MPB, përsëri ka dërguar mesazh të ri fyes ndaj gazetares, në bazë politike, por edhe në bazë fetare.

"Bëhet fjalë për një sulm verbal përmes rrjetit social Facebook, ofendimet janë dërguar në një mesazh personal. Sulmet ndodhnin menjëherë pas transmetimit të intervistave me ndonjë zyrtarë të lartë. Përveç sulmeve dhe fyerjeve në bazë fetare, duke përdorur fjalën "fanatik", disa nga mesazhet gjithashtu shprehnin edhe një formë kërcënimi "Unë duhet të të kisha takuar natën kur ishe duke punuar në ...". Kam marrë disa mesazhe me përmbajtje fyese nga i njëjti person," tregon Dodevska.

Siç kalonte janari, sikur kërcënimet u zvogëlonin, përderisa në skenën politike gjërat ekzagjeronin. Dhe përderisa zgjatnin trazirat në establishmentin politik, kah fundi i muajit, arriti sulmi i katërt, i cili në përmbajtjen e tij është një shembull i qartë i shtypjes së lirisë së fjalës, si dhe një kërcënim për jetën e gazetares. "Mendoj se askush nuk ju ka rrahur për një kohë të gjatë. Do të të vras për botimin e këtij artikulli", ky është mesazhi i marrë nga gazetarja dhe udhëheqësja e TV 21, **Almedina Ismaili.** Sulmi, sipas regjistrit të SHGM-së[1], është kryer nga një anëtar dhe aktivist i një partie politike. Arsyeja për kërcënimet ndaj gazetares është një kronikë televizive, në të cilën përmendet sulmuesi (i cili është i njohur për SHGM-në), pasi ai postoi informacion në profilin e tij në Facebook se po largohej nga partia e tij politike.

> *"Sulmi ishte përmes telefonit, me fyerje të ashpra dhe kërcënime për jetën. Personi reagoi në lidhje me një kronikë, në të cilin unë e citova atë, dhe paraprakisht unë i morra deklaratë në lidhje me të njëjtën gjë. Ai mu paraqiti kur mbaruan lajmet, nuk më pyeti asgjë, vetëm filloi të më tregojë se çfarë do të më bënte nëse nuk e fshija lajmin menjëherë, dhe çfarë dënimi do të ndiqte për mua për shkak se nuk e kam bërë kronikën ashtu siç duhet,"* tha Ismaili.

Me këtë sulm në janar mbyllet rrethi i sulmeve dhe kërcënimeve serioze ndaj gazetarëve. Katër sulme të forta në shtyllën e lirisë së medias, e cila është e barabartë me të gjitha sulmet e regjistruara në vitin 2019 në Maqedoni. Në të katër rastet, objekt i sulmeve dhe kërcënimeve janë gazetaret.

Siç kalonte shkurti, rastet e sulmeve ndaj gazetarëve të përmendura më parë u bënë tokë pjellore për akuza ndërpartiake, duke replikuar në mes tyre për sa i përket përgjegjësive dhe zhvillimeve me virusin e ri Covid-19. Më 26 shkurt, u regjistrua rasti i parë i koronavirusit në vend - një muaj më vonë edhe sulmi i pestë ndaj gazetarëve.

Më 27 mars, viti 2020, në emisionin "Trilling" i udhëhequr nga **Gorazd Çomovski**, i cili transmetohet në TV 24, ishte i ftuar kryetari i VMRO-DPMNE, **Hristijan Mickoski**, i cili gjatë emisionit reagoi ndaj gazetarit, i cili e krahasoi Mickoskin me ish kryeministrin Nikolla Gruevski, gjë për të cilën ai kërkoi falje nga Çomovski. Gjatë intervistës, si redaktor dhe udhëheqës, Gorazd Çomovski deklaroi se Mickoski nuk mund të dalë nga matrica e **Nikolla Gruevskit** sepse ai i ndan njerëzit në "tonët" dhe "të huajt", duke përmendur një shembull të situatës aktuale me koronavirusin, në të cilën lideri i opozitës thotë se ekipi i tyre shëndetësor është në dispozicion të qeverisë.

> "Unë mendoja se ky emision do të kalojë duke mos e përmend Gruevskin, por padyshim që ju jeni aq të mbingarkuar me të sa që edhe ky emision nuk mund të kalojë pa e përmend. Shpresoj se do të keni mundësinë të bëni një intervistë me z. Gruevski, në mënyrë që të merrni përgjigje për këto pyetje," tha Mickoski.

Në këto fjalë u përgjigj gazetari Çomovski, citojmë: "Unë nuk kam nevojë të bëj intervistë me një kriminel". Pas kësaj Mickoski tha, citojmë: "Ju lutem, të më kërkoni falje, sepse nëse e quani atë kriminel dhe mua më identifikon me matricën e tij, atëherë në mënyrë indirekte edhe mua më quani kriminel, prandaj do të doja të shfrytëzoj këtë rast dhe të kërkoj nga ju të më kërkoni falje." Gazetari iu

[1] https://znm.org.mk/znm-ostra-osuda-za-zakanite-kon-novina/

përgjigj: “Do të kërkoj falje në ndonjë rast tjetër”. Intervista me Mickoskin ishte arsyeja pse kryetari i partisë GROM, **Stevçe Jakimovski**, sulmoi ashpër gazetarin Gorazd Chomovski në profilin e tij në Facebook. SHGM menjëherë dënoi fyerjet dhe sulmet ndaj gazetarit[2] dhe u kërkoi institucioneve kompetente të marrin masa për të zgjidhur rastin.

“Çfarë pafytyrësie nga ai Alija Malisanoviqi - Gorazd Çomovski. Në fshatin tonë thonë se ai ka parë gjizë në atë sendin, dhe menjëherë vendos të bëjë vathë. Me disa intervista të bëra, mendoi se kush e di kush është. Pse është ashtu? Epo, sepse ai është në shoqërinë e qeverisë arrogante, siç thonë krokodilët. Fatkeqësisht, me fytyrën e tij duket si një bretkosë, e cila ndodhet midis syve të krokodilit dhe identifikohet me të. Kur ai hap gojën, edhe bretkosa e varfër e hap të veten, duke menduar se edhe ajo do të gëlltisë një pre të madhe, duke menduar se edhe ajo është një krokodil. Kanë të drejtë njerëzit kur thonë se arsimi shkatërron vetë-arsimimin tonë, por jo edhe komponentin e edukimit. Universiteti ofron arsim, por jo edhe kulturë dhe edukim. Edukimi jepet nga prindërit. Një sjellje e tillë arrogante duke refuzuar t’i kërkojë falje një zotëriu më të vjetër se ai, një profesori universiteti dhe lider opozite, në selinë e VMRO-DPMNE nuk mbahet mend. Unë e përgëzoj Hristijanin për qetësinë e tij, përndryshe i vogli meritoi ta kapë për veshët, ta ngrejë pak dhe ta hedhë në korridor jashtë, siç bënin mësuesit më herët”. - Gorazd Çomovski.

Vetëm tre ditë pas rastit të gazetarit Çomovski, edhe një rast i ri doli në sipërfaqe, të cilin shoqatat gazetareske e cilësuan[3] si një përpjekje të “Axhibadem Sistina” për censurë të drejtpërdrejtë dhe presion mbi redaksinë e “IRL.mk”, për shkak të publikimit të tyre të lajmit lidhur me Covid -19 me titull “Përfitimi pandemik ose kujdesi për bashkësinë: Ana tjetër e testeve për Covid-19”, botuar më 28 mars, viti 2020.

Zhvillime të tilla, ndër të tjerash, theksojnë rëndësinë e sigurisë së punonjësve mediatik, e cila në asnjë moment nuk guxon të rrezikohet. Çdo lloj sulmi ndaj gazetarëve, përfshirë edhe sulmet verbale, paraqesin sulme të drejtpërdrejta ndaj demokracisë dhe lirisë së fjalës në një shoqëri. Në kontekstin e këtij përkufizimi, prilli kaloi pa regjistruar ndonjë sulm të ri. Organizata Botërore e Shëndetësisë shpalli pandemi me Covid-19, kështu që gazetarët ishin plotësisht në shërbim të informimit të saktë të publikut. Gjatë asaj periudhe, në rrjetet sociale, gjuha e urrejtjes ndaj gazetarëve ishte e dukshme, si rezultat i pakënaqësisë së qytetarëve, dhe i inkurajuar nga korrespondenca e përditshme mes partive politike, për atë se kush dhe çfarë veprime ka ndërmarr për të mbrojtur popullatën.

Përderisa në muajin prill nuk janë vërejtur presione dhe reperkusione të dukshme mbi gazetarët, në rrjetet sociale, gazetari **Mishko Ivanov** i cili punon në TV 24 publikoi këtë:
“Ta q....a atë gruan komuniste, t’i q....a krejt të gjallët dhe të vdekurit në familjen tënde dhe të gjithë komunistëve së bashku me Zaevin, asaj me flokët e këputura dhe buallit nga Kumanova, varrin va q....a.”
Autori i kësaj përmbajtjeje është regjistruar me emrin e koduar Boban Petrovski, gjë që mund të vërehet nga

[2] https://znm.org.mk/osuda-za-navredite-i-zakanite-na-stevch/
[3] https://safejournalists.net/mk/reports/irl-mk-editorial-staff-verbal-attack-29-03-2020/

postimi i gazetarit Mishko Ivanov në profilin e tij në Facebook duke e komentuar atë me këto fjalë:
"Çfarë mund të them. Tmerr. Kjo përshëndetje më erdhi pas dy intervistave me Mickoskin dhe Zaevin. Jo se do të na frikësojë, por është mirë të shihet. Për shkak se heshtim, ata mendojnë se ne u frikohemi. Kjo duhet të marrë fund," shkroi Ivanov.

Për këtë rast, SHGM kërkoi nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe nga Prokuroria Publike të gjejnë personin që kërcënoi gazetarin.

Pasi Ivanov postoi mesazhin në profilin e tij në Facebook, gazetaret Aneta Dodevska dhe Natasha Stojanovska gjithashtu theksuan se kohët e fundit edhe ato kanë qenë shënjestër e sulmeve, domethënë edhe atyre u kanë dërguar mesazhe me përmbajtje të ngjashme.

Regjistri i sulmeve duke përfshirë këtu edhe sulmin e fundit arriti në tetë sulme. Sulmi i nëntë ishte i regjistruar më 28.05.2020 ndaj gazetarit **Furkan Saliu** dhe kameramanin **Ibrahim Mamuti** nga TV Klan. Saliu shpjegon për këtë ngjarje se ata ishin në terren duke xhiruar kronikë për një objekt i ndërtuar në mënyrë të paligjshme.

"Ne ishim duke xhiruar në fshatin Llojane, kishim informacion në lidhje me një objekt i ndërtuar në mënyrë të paligjshme, i cili përdoret për të strehuar emigrantë të paligjshëm. Gjetëm vendin, xhiruam një kronikë, ndërsa gjatë kthimit rrugën na preu një djalë i ri, i cili na tha që nëse publikohet kjo video, ai do të na vriste," tha Saliu.

Në ndërkohë, përderisa rastet e sulmeve janë në rritje, vendi ka filluar një fushatë elektorale për zgjedhjet e pesta të parakohshme parlamentare që nga pavarësia e shtetit, të planifikuar për në 15 korrik, viti 2020. Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KShZ) ka filluar përgatitjet për organizimin e zgjedhjeve dhe partitë politike kanë filluar luftën për të fituar besimin e qytetarëve. Dhe gjatë procesit rreth zgjedhjeve të parakohshme, situata në gazetarinë është e qetë, pa regjistruar sulme të reja, kërcënime, shantazhe dhe fyerje ndaj gazetarëve. Fushata për këto zgjedhje filloi më 24 qershor dhe zgjati deri më 12 korrik. Gjatë asaj periudhe, gazetarët monitoruan nga afër situatën, duke raportuar për çdo detaj, si dhe për zhvillimet me pandeminë Covid-19.

Një ditë para përfundimit të fushatës së partive politike, ndodhi një sulm i ri serioz ndaj gazetares **Tanja Milevska**, korrespodentë nga Brukseli për MIA-në. Më 11 korrik, një ditë para heshtjes zgjedhore, u shfaqën sulmet seksiste dhe kërcënimet me vdekje ndaj gazetares.

"Në korrik, viti 2020, para zgjedhjeve parlamentare, unë postova një "tweet" duke iu referuar videos së **Viktor Orbanit** *në të cilën ai i dha mbështetje VMRO-DPMNE-së, në të cilën Kryeministri hungarez e quajti vendin Maqedoni, dhe unë pyeta nëse ky ishte qëndrimi zyrtar i Hungarisë dhe në "tweet" i përfshiva Kryeministrin e* **Greqisë Micotakis** *dhe Partinë Populllore Evropiane, duke pyetur nëse është e pranueshme për ta Orban të mos përdorë emrin kushtetues të vendit tonë, Maqedonia e Veriut. "Ditë të tëra pas kësaj kishte sulme në rrjetet sociale nga përdorues anonimë dhe*

të njohur, me thirrje për vrasje dhe përdhunim, si dhe kërcënime personale të përdhunimit përmes mesazheve private në Facebook," tha Tanja Milevska.

Sulmet ndaj gazetares Milevska nuk morën fund me përfundimin e heshtjes zgjedhore dhe për këtë rast tregoi interes edhe Bashkimi Evropian.

Gjatë kohës së diskreditimit publik, veçanërisht ndaj gazetareve, pasionet e individëve u intensifikuan, të cilët kanalizuan zemërimin i cili ishte grumbulluar ndër vite ndaj gazetareve. Zgjedhjet mbaruan, në diskursin publik fjalimi u bë gjithnjë e më i vrazhdë, njerëzit nuk zgjidhnin fjalët që përdornin. E gjithë situata u ndez më tej nga retorika e politikanëve, mbështetësit e të cilëve, duke dashur të mbrojnë politikanët e tyre, përdorën çdo hapësirë për të përcjellë mendimin e tyre, i cili shpesh herë shoqërohej me gjuhë të urrejtjes. Më pak se dy javë pas 15 korrikut, ditës së zgjedhjeve, kishte një periudhë në të cilën gazetarët, përveç raportimit për pandeminë Covid-19, ishin në garë për të mbledhur informata.

Në javët në vijim, u regjistruan tre kërcënime të reja, kundër gazetarëve **Ljupço Zllatev** nga portali "Lider", aktivistëve nga "Civil Media" dhe gazetares **Mirosllava Burns** nga "Slloboden Peçat." Sulmi i njëmbëdhjetë është, në fakt, sulmi i parë fizik i regjistruar në vitin 2020. Objekt i sulmit ishte gazetari Ljupço Zllatev, i cili ndau më shumë detaje rreth ngjarjes dhe sulmit në rrjetin social Facebook:
"Ndërsa isha duke ecur nëpër korridor, një person i panjohur filloi të më godiste në gjoks, duke më pështyrë dhe duke më tërhequr drejt daljes. Përderisa ai po më sulmonte, personi më bërtiste "Dil jashtë, shumë na ke gabuar, dil jashtë..." Unë e kundërshtova sulmin e tij dhe nuk lejova të më tërheq jashtë, dhe më pas tek hyrja e lokalit, ai më shtrëngoi dhe më goditi në balli. Menjëherë pas incidentit, mysafirët erdhën nga brenda, duke e shtyrë sulmuesin jashtë lokalit, dhe në tërbim dëgjova se njeriu që më sulmoi po mbante armë."

Përveç gazetarit Zllatev, kontakti i dytë fizik me një gazetar u regjistrua më 9 shtator, viti 2020, në rrugën Makedonija në Shkup. Në një protestë të organizuar nga partia politike VMRO-DPMNE, gazetarja **Millka Smilevska** dhe kameramani **Jorde Angeloviq** nga televizioni Al Jazeera u sulmuan dhe u penguan gjatë kryerjes së detyrave të tyre profesionale nga një person i panjohur. Sulmuesi e shtyu mikrofonin nga dora e gazetares pasi pyeti për cilin medium po raportonin.

Partitë politike nuk mbeten imune për të shfrytëzuar momentin e sulmeve ndaj gazetarëve për akuza të ndërsjella, të cilat vetëm ndezën emocionet tek opinionin publik - qytetarët. Nga ana tjetër, gazetarët vazhduan të kryejnë detyrën e tyre për të bërë thirrje për informim të saktë të publikut sepse gazetaria ka vlerë shoqërore, kulturore, ekonomike, sociale dhe demokratike, pavarësisht nga mënyra e transmetimit të saj.

Nga ana tjetër, përgjegjësia është e pashmangshme edhe tek gazetarët, gjë të cilën shpesh herë e kujtonte

enciklopedisti francez **Didro**, në kontekstin e etikës së gazetarëve: “Nuk mjafton që një gazetar të ketë njohuri, por ai gjithashtu duhet të jetë i drejtë. Duhet të ketë gjykim të mençur dhe të thellë, përqendrim dhe të jetë i zgjuar. Asgjë nuk guxon të falsifikohet ose ndryshohet.” Nga ana tjetër, në kontekstin e sulmeve ndaj gazetarëve, të cilat mund të ndikojnë në pavarësinë editoriale,

, në librin e tij “Opinioni Publik, Komunikimi Masiv, Shoqëria Informatike” shkruan se: “Pavarësia editoriale. Federata Ndërkombëtare e Gazetarëve beson se vetë gazetarët kanë një përgjegjësi etike për cilësinë e informacionit dhe në veprimtarinë e tyre profesionale, të gjithë gazetarët duhet të jenë të lirë nga presioni, qoftë nga burime politike apo komerciale.”

Siguria e gazetarëve është thelbësore për ekzistencën e mediave të pavarura dhe profesionale, si dhe për ushtrimin e të drejtës së lirisë së shprehjes. Pa lirinë e mediave dhe informata cilësore për interesin publik, nuk është e mundur që proceset demokratike në vend të funksionojnë. Dhuna, ngacmimi dhe frikësimi i gazetarëve është një sulm ndaj demokracisë. Ato kanë efektin e mbytjes së lirisë së mediave dhe lirisë së shprehjes. Përpjekjet për kërcënime, presione, sulme dhe forma të tjera të përpjekjeve për të ndikuar në lirinë e raportimit të gazetarëve është një shembull klasik i përpjekjes për të heshtur gazetarët, duke ndikuar stilin e të shkruarit në ndërtimin e opinionit publik duke demonstruar fuqi. Ju kujtojmë se censura është e ndaluar me Kushtetutë dhe kërcënimet ndaj gazetarëve janë absolutisht të papranueshme, paraqesin vepra penale për të cilat njerëzit përgjigjen para gjykatave.

III. GAZETARËT PËR SULMET DHE KËRCËNIMET: U MËSUAM MË, DHE KJO NUK ËSHTË NJË GJË PËR TU KRENUAR

Megjithëse numri i sulmeve fizike në vitin 2020 është më i ulët se numri i sulmeve verbale, brengos fakti që gjithnjë e më shumë kërcënime për jetën e gazetarëve po ndodhin në rrjetet sociale dhe në platformat e tjera të komunikimit në internet. Një shqetësim i veçantë është fakti se sulmet përfshijnë gjithashtu bartës të funksioneve publike, si dhe përfaqësues të institucioneve shtetërore, si dhe përfaqësues të lartë të partive politike. Më shpesh, për rastet zbulohet pasi vetë gazetarët informojnë se çfarë u ka ndodhur dhe për çfarë lloj të sulmit/kërcënimit bëhet fjalë ose pasi SHGM-ja dënon publikisht rastin.

Dodevska: institucionet duhet të jenë më efikase

Figurat publike nuk mund dhe nuk duhet të kursehen nga kritikat dhe vëzhgimet e qytetarëve. Në këtë rast, puna jonë gazetareske është publike dhe i nënshtrohet kritikave publike, pa marr parasysh a është pozitive apo negative. Unë do të thoja që sulmet verbale do të ishin pjesë e "dekorit" ndaj të cilit jemi të ekspozuar, por kjo është arsyeja pse sistemi duhet të jetë këtu, institucionet, të cilat duhet të reagojnë në raste të tilla, veçanërisht nëse bëhet fjalë për një kërcënim që prek dhe rrezikon sigurinë e gazetarit." - Aneta Dodevska

Koroveshovska: sulmet janë reflektim i fotografisë së keqe demokratike

"Sulmet ndaj gazetarëve, nga çdo profil i sulmuesve, janë një pasqyrim i situatës së dobët demokratike në një vend, i cili reflekton në mënyrë të pashmangshme mbi sigurinë e veprimit gazetaresk." - Iskra Koroveshovska

Jordanovska: realiteti është i tmerrshëm



"Jam mësuar. Dhe kjo nuk është e mirë. Sidomos ndaj grave gazetare, sulmet zakonisht i referohen pamjes, veshjeve, etj, dhe jo punës. Epo, edhe kur shkruajmë tekstin më profesional, ekziston mundësia që komentet të reduktohen në insinuata dhe shpifje të tipit "dashnorja e kujt është kjo gazetare", në vend që të përqendrohen në përmbajtjen e tekstit. Ky është realiteti në të cilin po jetojmë tani dhe kjo është e tmerrshme, sikur të jemi kthyer me shekuj mbrapa. Kjo demotivon, shqetëson dhe është një rrezik real shoqëror që dëshmon vetëm se sa jemi mbrapa për sa i përket barazisë gjinore, për sa i përket perceptimit të përmbajtjeve që publikojmë dhe së fundmi, për sa i përket gjithë përpjekjes që kemi bërë në profesionin të cilit i jemi përkushtuar pa masë." - Meri Jordanovska

Stojanovska: shteti ndryshe trajton gazetarët përkundër politikanëve



Sulmet ndaj gazetarëve janë shqetësuese pasi ato po ndodhin gjithnjë e më shpesh dhe reagimi i institucioneve është i papërshtatshëm. Shqetësuese sepse, përveç fyerjeve në rrjetet sociale, ne shpesh marrim kërcënime për jetën tonë në mesazhe në inboks, thjesht sepse dikujt nuk i kanë pëlqyer emisionet, lajmet, hulumtimet, analizat. Nga institucionet gjithmonë marrim përgjigje të papërshtatshme sepse edhe kur përpiqemi të kërkojmë ndihmë nga institucionet, ata na sugjerojnë të ngritim padi private për fyerjet dhe kërcënimet. Por, kjo është krejt ndryshe kur bëhet fjalë për politikanët. Në atë rast, kemi një reagim të shpejtë, madje edhe pas zërit të prekur, veçanërisht nëse bëhet fjalë për ndonjë zyrtar të lartë që ka marrë kërcënime ose fyerje." - Natasha Stojanovska

Ismajli: sulmet na demotivojnë

"Sulme të tilla janë skandaloze, duke pasur parasysh që ju i jepni një personi të caktuar respekt dhe mundësinë për të qenë pjesë e një lajmi të transmetuar në televizion. Kjo na demotivon shumë sepse nuk na lënë vend që ne gazetarët të kryejmë detyrat tona siç duhet dhe na heqin "fuqinë" që ne mendojmë se e kemi për t'i ndryshuar gjërat për mirë. Ata thjesht e degradojnë profesionin e gazetarit". - Almedina Ismaili

Çomovski: pafuqia e politikanëve nuk guxon të derdhet mbi gazetarët

"Sulmet ndaj punonjësve mediatik nga ana e politikanëve ose partive politike tregojnë se sa i pjekur është mjedisi demokratik në vend. Fatkeqësisht, subjektet politike, të paafta për t'u përballur me të vërtetën dhe për t'i bërë ballë kritikave, shpesh herë i sulmojnë gazetarët. Për nivelin e lirisë së mediave, unë do t'ju referoj vetëm në raportet e Freedom House dhe Reporterët pa Kufij." - Gorazd Çomovski

Saliu: nuk ka respekt të mjaftueshëm për këtë profesion

"Thjesht nuk ka respekt të mjaftueshëm për këtë profesion! As nga pronarët, të cilët nuk sigurojnë kushte normale të punës dhe të ardhura normale, as nga policia dhe organet gjyqësore, të cilët thjesht nuk i marrin seriozisht sulmet ndaj gazetarëve." - Furkan Saliu

Milevska: gazetaret janë më të ekspozuara ndaj kërcënimeve

"Besoj që sulmet ndaj gazetarëve që bëhen përmes rrjeteve sociale duhet të merren shumë më seriozisht nga ana e SHGM-së dhe institucionet, dhe vëmendje e veçantë duhet t'iu kushtohet kërcënimeve me bazë gjinore ndaj grave gazetare. Amnesty International, në vitin 2018, publikoi një raport të rëndësishëm mbi toksicitetin e platformës Twitter për gratë gazetare dhe gratë në përgjithësi që janë aktive në skenën publike, duke përfshirë politikanet, intelektualet, komentueset, etj. Anonimiteti i lejuar nga Twitter, pasiviteti i platformës kur bëhet fjalë për çështje gjinore dhe paaftësia e autoriteteve kombëtare për të sfiduar arbitraritetin e platformave sociale private janë një rrezik i veçantë për gratë. Në të njëjtën kohë, lëvizje të tilla si Qanon dhe grupe të tjera nacionaliste, raciste dhe seksiste janë në rritje, duke e përhapur ndikimin e tyre globalisht, dhe në shumë demokraci perëndimore tashmë konsiderohen si kërcënim terrorist. Prej këtyre grupeve shpesh herë dalin kërcënime për përdhunime dhe vrasje të grave, gratë gazetare janë ndër personat më të ekspozuara dhe këtu duhet të merren masa urgjente për të luftuar këtë fenomen."

IV. STANDARDE TË DYFISHTA KUR BËHET FJALË PËR SHKELJEN E SIGURISË SË GAZETARËVE KUNDREJT POLITIKANËVE

Edhe pse sulmet fizike sot janë në numër më të vogël në krahasim me sulmet verbale, brengos fakti që po regjistrohen gjithnjë e më shumë kërcënime për jetën e gazetarëve në rrjetet sociale. Një shqetësim i veçantë është fakti që zyrtarët publikë dhe përfaqësuesit e institucioneve shtetërore janë gjithashtu të përfshirë në këto sulme. Më shpesh, rastet zbulohen pasi vetë gazetarët zbulojnë se çfarë u ka ndodhur dhe për çfarë lloj sulmi/kërcënimi bëhet fjalë.

Për shkak të praktikës së mosndëshkimit, në shumë raste, gazetarët nuk ishin të motivuar për të paraqitur rastin në institucionet përkatëse. Analiza e Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë tregon se mosndëshkimi nga ana e institucioneve në lidhje me sulmet ndaj gazetarëve është akoma në një nivel shumë të lartë. Në raportin e fundit të SHGM-së thuhet: “Në rrethin e formuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, Prokuroria Publike dhe gjykatat, së paku një nga këto tre institucione pothuajse gjithmonë dështon, por më së shpeshti ajo është Prokuroria Themelore Publike, sepse kur ky institucion është kompetent për të hetuar ndonjë vepër penale, rrallë ndodh ajo të ngritë aktakuza para Gjykatës Penale. Në dy vitet e fundit, për fat të keq, kjo është bërë gjithnjë e më e theksuar në Prokurorinë Publike, e cila në disa raste të sulmeve ndaj gazetarëve nuk ka ndërmarrë asnjë veprim, dhe në rastet kur ka filluar hetimet, ato i kryen shumë ngadalë dhe në mënyrë joefikase.

Disa nga gazetarët që ishin subjekt i sulmeve dhe kërcënimeve, përmes bisedave me ta për qëllimet e kësaj analize, mësuam se ata besojnë se ekzistojnë standarde

të dyfishta kur bëhet fjalë për shkeljen e sigurisë së gazetarëve përkundër politikanëve në qasjen e veprimit institucional.

Sipas gazetares Tanja Milevska: “Institucionet reagojnë menjëherë dhe pas zërit të prekur kur politikanët janë nën kërcënim, ndërsa gazetarët çdo ditë përballen me gjuhë të urrejtjes, presione politike dhe ekonomike, kërcënime, rrezik për shëndetin e tyre, ndërsa fyerjet dhe kërcënimet ndaj gazetarëve konsiderohen si gjë normale nga publiku. Gazetarët nuk mbrohen gjithmonë nga redaksitë dhe redaktoret e tyre. Nuk ka struktura për ndihmë dhe mbështetje në këtë drejtim, këtu SHGM dhe SPGPM duhet të luajnë një rol të rëndësishëm,” tha Milevska.

Gazetari Furkan Saliu beson se standardet e dyfishta, kur bëhet fjalë për sulmet ndaj gazetarëve dhe politikanëve, janë më se të dukshme: “Sa njerëz, vetëm në 6 muajt e fundit, kanë fituar kallëzime penale për kërcënime ndaj zyrtarëve në rrjetet sociale? “Thjesht, Ministria e Punëve të Brendshme, Prokuroria Publike dhe gjyqësori duhet të kuptojnë njëherë e përgjithmonë se pa funksionimin normal të mediave, nuk ka demokraci normale dhe shtet normal.”

Institucionet duhet të tregojnë se me të vërtetë ekziston vullneti dhe aftësia politike për veprim joselektiv - pavarësisht a bëhet fjalët për gazetar, zyrtar apo qytetar i zakonshëm, të drejtat dhe siguria e të cilit rrezikohen, tha gazetarja Aneta Dodevska, duke theksuar se të gjithë janë të barabartë para ligjit.

“Në periudhën e kaluar, është regjistruar që institucionet kanë vepruar sipas detyrës zyrtare për sulme dhe kërcënime kundër zyrtarëve, por kjo nuk ndodhi edhe në rastet e gazetarëve të sulmuar. SHGM u siguroi logjistikë kolegëve për t’i paraqitur kërcënimet, por mbetet hapur pyetja nëse institucionet veprojnë në mënyrë selektive për të njëjtat raste të kërcënimeve dhe fyerjeve,” tha Dodevska.

“Nuk mendoj se institucionet përkatëse po marrin masa për të mbrojtur gazetarët. Shumë shpesh, forca e shtatë lihet të luftojë vetë,” shpjegon gazetari Gorazd Çomovski, në kontekstin e standardeve të dyfishta.

“Shpesh jemi dëshmitarë të standardeve të dyfishta dhe përshtypja ime është që institucionet përkatëse janë shumë të ngadalta për të zgjidhur rastet në të cilat janë përfshirë punonjësit mediatik,” tha Çomovski.

“Në situatat kur gazetarët përpiqen të kërkojnë ndihmë nga institucionet, atyre u sugjerohet të ngritin padi private,” shpjegon gazetarja Natasha Stojanovska.

“Por, është krejtësisht ndryshe kur bëhet fjalë për politikanët. Në atë rast, ka reagim të shpejtë, madje edhe pas zërit të prekur, veçanërisht nëse bëhet fjalë për një zyrtar të lartë që është kërcënuar ose fyer,” tha Stojanovska.

Gazetarja Iskra Koroveshovska është gjithashtu kategorike, duke shpjeguar se gazetarët dhe politikanët nuk kanë trajtimin e njëjtë.

“Kemi situata kur sulmet ndaj politikanëve marrin zgjidhje institucionale në një kohë shumë të shkurtër, ndërsa gazetarët presin me muaj dhe vite të tëra proceset gjyqësore. Ka gjithashtu edhe raste kur politikanët, që absolutisht janë fajtorë, lirohen nga çdo përgjegjësi ndërsa gazetarët dënohen brenda natës, madje edhe kur informacioni për të cilin ata janë dënuar është në interesin absolut të publikut,” tha ajo.

Politikanët janë ata që duhet të tregojnë respekt për mediat dhe gazetarët, thotë gazetarja Almedina Ismajli, duke shtuar se shumë kërcënime ndaj gazetarëve vijnë pikërisht nga njerëz që janë bartës të pozitave të larta të pushtetit.

“Në atë rast, institucionet janë të kufizuara dhe kanë frikë të reagojnë. Institucionet duhet t’i zbatojnë lëndët deri në fund në mënyrë që ato të kenë epilog, t’i japin fund kërcënimeve dhe rasteve të dhunës. Sigurisht që politikanët dhe gazetarët nuk janë të barabartë,” thekson Ismajli.

Se ka standarde të dyfishta kur bëhet fjalë për shkeljen e sigurisë së gazetarëve dhe politikanëve në procesin e zgjidhjeve institucionale, gazetarja Meri Jordanovska shton se politikanët janë “arinj të mbrojtur” në këtë vend, pa marrë parasysh kush është në pushtet.

“Është sikur të ketë një marrëveshje të heshtur midis partive politike, që askush të mos dënohet për keqpërdorimin e parave të qytetarëve. Dhe jo vetëm për këtë, por edhe për gjëra krejtësisht të tjera dhe më banale, të tilla si kërcënime, shantazhe etj. Ne jemi një shtet partiak ku gjithçka fillon dhe mbaron me politikë, prandaj politikanët janë më të mbrojturit dhe ata që vijnë të parët deri te e ashtuquajtura drejtësi, ose më mirë, ata që më lehtë kalojnë për diçka që kanë bërë ose nuk kanë bërë. Në një shtet të tillë, është shumë e vështirë të arrihet dhe është veçanërisht e vështirë të punosh profesionalisht si gazetar.”

Për pretendimet e gazetarëve që ekzistojnë standarde të dyfishta flet edhe fakti që Ministria e Punëve të Brendshme, në një buletin të botuar më 9 shkurt të vitit 2018, ka dokumentuar 30 raste të “rrezikimit të sigurisë” dhe “abuzimit të të dhënave personale” përmes rrjeteve sociale.

Më konkretisht, Sektori për krim kompjuterik dhe forenzikë digjitale në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në përputhje me kompetencat e tyre ligjore, kanë dokumentuar dhe proceduar tridhjetë raste, në të cilat, përmes rrjeteve sociale, është rrezikuar siguria e zyrtarëve shtetërorë në Republikën e Maqedonisë, si dhe raste kur janë keqpërdorur të dhënat e tyre personale. Për të gjitha ato raste, në përputhje me normat ligjore, janë përgatitur njoftime për prokurorin publik kompetent në Prokurorinë Themelore Publike Shkup, me qëllim të përcaktimit të elementeve të dyshimit për vepra penale që ndiqen me detyrë zyrtare në fushën e krimit kompjuterik.

“Si raste më karakteristike, janë detektuar gjashtë vepra penale për kërcënime ndaj Kryeministrit të Republikës së Maqedonisë, ato janë të dokumentuara, me njoftime përkatëse për Prokurorinë Publike dhe urdhra të dhëna për rr-

jetin social Facebook. Në këtë mënyrë, nga gjashtë veprat penale, është zbuluar një person i dyshuar për kryerjen e veprës penale - "rrezikimi i sigurisë" (dënohet sipas nenit 144, paragrafi 3 i Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë), dhe i referohet një botimit të regjistruar në një portal maqedonas, pas një artikulli të botuar më parë në rrjetin social Facebook, i cili në formë të kërcënimit i është drejtuar Kryeministrit të Republikës së Maqedonisë. Në këtë rast, i dyshuari për veprën penale u zbulua në koordinim me Sektorin për Bashkëpunim Policor Ndërkombëtar, me rrjetin social Facebook, si dhe me Interpol-Bern (Zvicër) dhe një internet-provajder nga Zvicra. Pas dokumentimit të plotë të lëndës, kundër të dyshuarit do të ngrihet kallëzim penal në Prokurorinë Publike."

Në këtë kontekst të qëndrimit të institucioneve shtetërore ndaj sigurisë së gazetarëve, dhe në drejtim të efikasitetit në mbrojtjen e gazetarëve, kryetari i Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë, **Mlladen Çadikovski,** u kërkoi autoriteteve masa urgjente për të përmirësuar situatën me sulmet ndaj gazetarëve. Por, ai gjithashtu kërkoi nga Prokuroria Themelore Publike të krijojë një njësi të veçantë për të ndjekur penalisht sulmuesit e gazetarëve.

"Kërkojmë, në periudhën në vijim, Ministria e Drejtësisë të bëjë ndryshime në Kodin Penal. Me ndryshimet duhet të zgjerohen kompetencat e prokurorisë për të vepruar sipas detyrës zyrtare në krimet që lidhen me sulmet ndaj gazetarëve dhe të rrisin dënimet për sulmuesit. Në të njëjtën kohë, ne i kërkojmë Prokurorisë Publike të krijojë një njësi të veçantë, e cila do të ndjekë penalisht sulmuesit e gazetarëve. Sulmi mbi gazetarëve është sulm ndaj demokracisë dhe kjo është e papranueshme për një vend që dëshiron të fillojë negociatat për anëtarësim në BE," tha Çadikovski.

SPGPM në vitin 2017, për nevojat e forcimit të ndëshkimeve për sulmet ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik, përgatiti një analizë të cilën e përdor për të lobuar për ndryshime në Kodin Penal. Të njëjtin qëndrim sikur SHGM, e ka edhe SPGPM kur kërkon t'i vihet fund mosndëshkimit të sulmeve ndaj gazetarëve. **Darko Duridanski** nga SPGPM thekson se duhet të bëhen ndryshime në Kodin Penal, domethënë, çdo sulm ndaj gazetarëve të konsiderohet si sulm ndaj një zyrtari.

"Ne kërkojmë që sulmi ndaj një gazetari të trajtohet sikur sulm ndaj një zyrtari, por vetëm në pjesën me të cilën prokuroria do të jetë e detyruar të hapë lëndë sipas detyrës zyrtare, si dhe të rriten dënimet. Kërkesat bazohen në përvojën shumë vjeçare, e cila ka treguar se institucionet ia hedhin topin ose më saktë përgjegjësinë njëri-tjetrit. Nga ana tjetër, për shkak të mosbesimit ndaj sistemit, si dhe shpenzimeve të larta, gazetarët dhe punonjësit mediatik rrallë vendosin të padisin, siç është rasti me ligjin aktual. Si për ilustrim që zgjidhja aktuale nuk është duke funksionuar, tregon fakti që nga gjithsej 18 sulmesh në vitet 2019 dhe 2020, vetëm një është zgjidhur."

Ministri i Drejtësisë, **Bojan Mariçiq**, në fjalimin e tij, gjatë uebinarit të organizuar nga SHGM më 26 nëntor, viti 2020,

theksoi se Ministria e Drejtësisë ka filluar procedurë për hartimin e një Kodi të ri Penal me ndryshimet e kërkuara, në të cilin do të përfshihen edhe vepra penale me të cilat do të rritet niveli i mbrojtjes së gazetarëve, por edhe të punonjësve mediatik në përgjithësi.

"Për të përgatitur një tekst cilësor në ligj, tashmë kemi mbajtur një takim me përfaqësuesit e profesionit gazetaresk dhe shoqatat e gazetarëve, përfshirë edhe Shoqatën e Gazetarëve të Maqedonisë dhe Sindikatën. Propozimet e tyre janë siguristht të mirëseardhura sepse vetëm përmes dialogut të hapur, pikërisht me gazetarët do të mund të sjellim një ligj të ri, i cili do t'i mbrojë ata edhe më tepër në mënyrë që të mund të kryejnë punën e tyre, dhe të gjithë ata që do të përpiqen t'i frikësojnë gazetarët dhe punonjësit mediatik, qoftë fizikisht ose verbalisht, do të ndëshkohen në mënyrë rigoroze," tha Mariçiq.

Premtimet e tilla, si ato të Ministrit të Drejtësisë, janë të njohura për publikun, duke pasur parasysh faktin se edhe ministrat e mëparshëm të drejtësisë kanë premtuar të njëjtën gjë, por do të shihet nëse këto premtime do të realizohen deri në fund në të ardhmen. Mbetet angazhimi për t'i marr me seriozitet kërkesat e shoqatat të gazetarëve për të krijuar një sistem efikas i mbrojtjes së gazetarëve, i cili do të kontribuonte që në të ardhmen të ketë më pak sulme ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik.

V. PRAKTIKA GJYQËSORE DHE EFIKASITETI NË MBROJTJEN E GAZETARËVE

Bazuar në të dhënat nga regjistri i SHGM-së për sulmet ndaj gazetarëve, është e qartë se pothuajse të gjitha sulmet e regjistruara ndaj gazetarëve, pas paraqitjeve të rasteve nga ana e të dëmtuarve - gazetarët, asnjë lëndë nuk ka pasur zgjidhje institucionale-ligjore me rezultat të duhur. Asnjë nga autorët e krimeve nuk është dënuar para gjykatës përkatëse. Përjashtim nga praktika negative e gjykatës është vendimi pozitiv, të cilin Gjykata Themelore Penale e solli në favor të gazetares Meri Jordanovska.

Vendimi për lëndën me gazetaren Meri Jordanovska kundër Emil Jakimovskit u shqiptua në Gjykatën Penale të Shkupit nga ana e gjykatëses **Xheneta Begtoviq**. Prokuroria propozoi dhe gjykata pranoi. Emil Jakimovski u dënua me një vit e tetë muaj burg për rrezikimin e sigurisë së ish-gruas së tij dhe për kërcënimet ndaj gazetares Meri Jordanovska.

Në raportin e fundit të SHGM-së për këtë temë thuhet se arsyetimi i Gjykatës Themelore Civile dhe Penale në Shkup është se sistemi i ri i menaxhimit të lëndëve (AKMIS) bazohet në kode, e jo në emrat dhe në profesionet e palëve dhe prandaj është e vështirë të arrihet deri tek detajet e procedurave gjyqësore. Në vitin 2020, sipas SHGM-së, në pjesën e bashkëpunimit thuhet se Gjykata Themelore Civile ka siguruar qasje në informacion vetëm për numrin e përgjithshëm të lëndëve për shpifje dhe fyerje, por jo edhe në informatat për atë se në sa prej tyre njëra nga palët është gazetar ose medium. SHGM thotë që mosndëshkimi i autorëve të sulmeve mbetet i lartë dhe zgjidhje gjyqësore për lëndë të tilla ka pasur në më pak se 10 për qind të rasteve të regjistruara.

Jordanovska: Unë e konsideroj këtë rast si një shembull pozitiv - pres që institucionet do të veprojnë në mënyrë të njëjtë në të gjitha rastet

Dhuna e Emil Jakimovskit ndaj gruas së tij dhe kërcënimet ndaj gazetares Meri Jordanovska i sollën atij një vit e tetë muaj burg, me trajtim të detyrueshëm psikiatrik. Ky nuk është vendimi i parë për Jakimovskin, ai më parë ka marrë një dënim me kusht për dhunë ndaj gruas së tij, e cila, sipas fjalët e gjykatëses Xheneta Bektoviq, ishte një rrethanë rënduese në përcaktimin e dënimit. Jordanovska e mirëpriti këtë vendim të gjykatës.

"Vendimi kundër Emil Jakimovskit, i iniciuar nga Prokuroria Publike, në lidhje me rastin tim, i referohej veprës penale "rrezikimi i sigurisë përmes sistemit informatik." Në mesazhet, që ai më dërgoi në rrjetin social Telegram në janar të vitit 2020, kishte elementë të fyerjeve, por edhe kërcënime për jetën time, diçka që më shqetësoi seriozisht, veçanërisht pasi personi kishte informacion të saktë për atë se ku jetoj, dhe vendbanimi i tij ishte afër ndërtesës sime.

Vendosa të publikoj fotografi me mesazhet që përmbanin kërcënimet në profilin tim në Facebook, në mënyrë që të tregoj një shembull se si nga një pozitë e fuqisë, nëpunës të caktuar trajtojnë gazetarët, për të treguar se me çfarë probleme jemi duke u përballuar gjatë kryerjes së punës tonë. Reagimet që mora ishin vërtet të papritura. Zakonisht jemi mësuar të postojmë kërcënimet ose fyerjet, duke i përhapur ato në rrjetet sociale, por duke mos shkaktuar kurrfarë epilogu.

Në këtë rast, për habinë time, nuk ishte kështu. Menjëherë më pranuan në Njësinë për krim të dhunshëm në MPB, shefi i njësisë **Dejan Dimovski** dhe shefi i Sektorit të krimit të dhunshëm **Rijad Ajeti** shpjeguan në detaje dhe saktësisht atë që unë mendoj se është e rëndësishme për të gjithë gazetarët - që paraqitja e rastit do të jetë e plotë vetëm nëse personi kërcënon drejtpërdrejt jetën time, e jo nëse më fyen. Kjo është ajo që përcakton Kodi Penal dhe kërcënimet për jetën ishin ato që me të vërtetë "kontribuuan" në marrjen e këtij vendimi të gjykatës. Nëse një gazetar përballet me fyerje, ai ose ajo mund të paraqesë një padi civile private. I tillë ishte rasti me kolegen time, e cila ashtu si unë, ka pranuar mesazhe nga i njëjti person, në rastin e saj kishte vetëm fyerje, por nuk kishte kërcënime dhe për këtë arsye procedura u ndërpre. Prokuroria veproi shpejtë, seancat vazhduan pa vonesë dhe sinqerisht e konsideroj këtë rast si një shembull pozitiv në punën e institucioneve, kur ne si gazetarë përballemi me ngacmime, pra kërcënime të këtij lloji. Sidoqoftë, pres që institucionet të veprojnë në mënyrë të barabartë në të gjitha rastet, jo vetëm në ato ku ngrihet "pluhuri" në publik. Ligjet duhet të vlejnë në mënyrë të barabartë për çdo gazetar dhe për çdo qytetar, pavarësisht se kush është më i zëshëm ose kush ka më shumë ndjekës në Facebook," tha gazetarja Meri Jordanovska.

Rasti i 27 prillit dhe gazetarët që raportuan nga kuvendi

Rreth katër vjet më parë, më 27 prill, pak pas orës 18, bulevardi kryesor midis Kuvendit dhe "Parkun e Gruas" u mbyll për trafik për shkak të një proteste nga një grup i madh qytetarësh. Gazetarët kishin dalë në terren, disa prej tyre raportonin për ngjarjet që ndodhnin jashtë para Kuvendit, në rrugë, ndërsa të tjerët ishin brenda Kuvendit. Para orës 19, "skenari" i vendosur nga pjesëmarrësit në protestën publike filloi të realizohej. Dyert e Kuvendit janë të hapura - protestuesit hynë në Parlament. Publiku dëshmonte këtë ngjarje. Informatat ndryshonin nga sekonda në sekondë. Padurimi po rritej, lajme të ndryshme, si dhe video materiale u përhapën në hapësirën mediatike, të cilat u siguruan pikërisht nga gazetarët dhe punonjësit mediatik, të cilët u gjetën brenda Parlamentit në atë kohë. Fotografia u bë e përgjakshme, gazetarët "të heshtur" nga turma, duke u përpjekur të sigurojnë informata, u gjendën në kthetrat e protestuesve, por sot gjenden edhe në kthetrat e gjyqësorit. "E enjtja e përgjakshme", pra 27 prilli, padyshim hyn në historinë e gazetarisë nga dy aspekte, përpjekja për të mbytur mendimin e lirë dhe beteja heroike për të vërtetën, për të cilën luftuan gazetarët atë ditë. Në këtë ditë, shumë gazetarë dhe punonjës mediatik ishin viktima të ndërhyrjes në Parlament. Ata u rrahën, dhe u maltretuan psiqikisht. Pas një kohe të gjatë, për shkak se shteti dështoi, gazetarët vendosën vetë të kërkojnë drejtësi për atë që u ndodhi.

Në vitin 2020, disa nga gazetarët që u sulmuan gjatë "të enjtes të përgjakshme" të ndihmuar nga SHGM përmes zyrës së avokatit "Medarski", ngritën padi private kundër shtetit për shkeljen e të drejtës së lirisë së shprehjes dhe për kompensimin e dëmit jopasuror.

Kanë kaluar rreth 9 muaj nga dita e paraqitjes deri në ditën e pushimit të padive. Gazetaret Natasha Stojanovska dhe Dushica Mrgja u ndeshën me portat e "mbyllura" të gjykatës. Gjykata Civile në Shkup vendosi t'i refuzojë dy paditë e gazetareve, për të cilat Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë do të reagojë: "Gazetarët nga 27 prilli janë viktima për herë të dytë, këtë herë nga gjykata."

RASTI 1: NATASHA STOJANOVSKA DHE GJYKATA THEMELORE CIVILE - SHKUP

Gjyqësori nuk mësoi leksionet nga e kaluara

"A nënkupton ky qëndrim i gjykatës se është duhur të na lëndojnë, ose mos zot të kishim mbaruar më keq, që padija të jetë e arsyetuar?"

PADIJA ËSHTË E REFUZUAR

"Paditësja, në vend që të tregonte frikë dhe të kujdesej për shëndetin dhe integritetin e saj trupor, ajo vazhdoi të raportojë."

Më 24 nëntor, viti 2020, në emër të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gjykata Themelore Civile - Shkup, përmes gjyqtarit **Eroll Abduli**, sjell një AKTGJYKIM me të cilin padia e gazetares Natasha Stojanovska REFUZOHET SI E PAARSYETUAR.

Në arsyetimin e gjykatës thuhet se:
"Bazuar në një vlerësim të ndërgjegjshëm dhe të kujdesshëm të secilës provë veç e veç dhe të gjitha provave së bashku, gjykata konstatoi se si pasojë e ngjarjeve në ndërtesën e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut më 27 prill, viti 2017, paditësja nuk ka pësuar lëndim trupor ose dëmtim të pasurisë së saj."

Më tej në aktgjykimin thuhet edhe kjo:
"Për shkak të mungesës së provave, gjykata nuk arriti të përcaktojë nëse bëhet fjalë për një akt terrorist, demonstrata publike apo manifestime. Provat për të përcaktuar kualifikimin e saktë të ngjarjeve nuk u paraqitën nga asnjëra palë."

Në lidhje me këtë argument për refuzimin e padisë, gazetarja Natasha Stojanovska nënvizon me një pyetje rezervë: "A nënkupton ky qëndrim i gjykatës që është duhur të na lëndojmë, ose mos zot të kishim mbaruar edhe më keq, që të jetë e arsyetuar kjo padi?"

"Në Parlament, unë, si dhe kolegët e mi që ishin të pranishëm, po bënim punën tonë, por jo vetëm që u penguam në këtë, por u sulmova gjithashtu nga turma që hyri brenda, në një moment unë isha peng dhe nuk mund të telefonoja në redaksinë time. Vetëm përqendrimi im më shpëtoi nga ajo që mund të kishte ndodhur. Jeta ime ishte në rrezik, ashtu siç ishin në rrezik jetët e disa deputetëve, për të cilët gjykata tani thotë se policia është duhur tu kishte dhënë përparësi për t'i mbrojtur."

Në arsyetimin e aktgjykimit, ndër të tjerash, thuhet se:
"Pasi një turmë qytetarësh ka hyrë në ndërtesën e Kuvendit dhe është sjellë në mënyrë të dhunshme, llogaritet se Kuvendi ka ndaluar me mbajtjen e seancës, prandaj atë për të cilën paditësja ka qenë e akreditуar të raportojë ka mbaruar, kështu që nuk mund të pranohet që e drejta e saj lirisë së shprehjes ishte e shkelur. Gjykata vëren se paditësja, në vend që të tregojë frikë dhe të kujdeset për

shëndetin dhe integritetin e saj trupor, deklaron se edhe pas hyrjes së turmës në Kuvend ajo ka qenë e kyçur drejtpërdrejtë në profilin e saj në Facebook në mënyrë që të raportojë, për, siç shpjegon ajo, kaosin në ndërtesën e Kuvendit."

Por gazetarja Natasha Stojanovska thekson: "Frikën që ndjeva në ato momente, kur jeta ime ishte vërtet e rrezikuar për shkak të çmendurisë së individëve, në sytë e të cilëve shihej dëshira për të parë gjak, ndërsa gjithandej dëgjoheshin thirrjet të tilla si "Vritini ata" - me asgjë nuk mund të kompensohet. Dhe është shqetësuese që gjykata nuk e pranon që frika që ndjeva në ato 12 orë dhe trauma që ishte e pranishme edhe shumë kohë, janë arsye të mjaftueshme për pranimin e padisë, duke qenë se shkaktimi i frikës si pjesë e segmenteve të shëndetit mendor është një lëndim trupor. E drejta për shëndet mendor është një e drejtë personale, e definuar vetëm disa vjet më parë në ligjin tonë, dhe gjykatësit nuk duhet të kenë problem ta kuptojnë atë koncept."

Për më tepër, në aktgjykimin e gjykatës, në të cilin kemi pasur qasje, thuhet edhe kjo:
"Siç u shpjegua, në aktet e terrorizmit ose demonstratave, shteti ka për detyrë të mbrojë integritetin njerëzor, kështu që në këtë rast ai ishte i detyruar vetëm të siguronte jetën dhe shëndetin e paditëses, dhe jo të mbronte të drejtën e saj gazetareske, veçanërisht në një situatë ku ngjarja për të cilën gazetarja ishte e akreditуar ishte e ndërprerë nga një veprim i personave të tjerë, dhe në fakt ajo ka dashur të raportojë për kaosin që po ndodhte brenda Kuvendit. Sipas logjikës së paditëses, rrjedh se shteti, përmes organeve të mbrojtjes, në vend që të kujdeset për shëndetin e deputetëve dhe të pranishmëve të tjerë që nuk ishin pjesë e turmës së dhunshme, është duhur t'i mundësojë gazetares të raportojë për ngjarjen, ndërsa të gjithë e dinë se të pranishmit me shumë vështirësi u larguan nga ngjarja. Kjo kërkesë e paditëses u vlerësua nga gjykata si mosmirënjohëse, sepse rrjedh se organet e rendit është duhur të mos vazhdojnë me mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të të tjerëve, dhe është duhur të orientohen për të mbrojtur të drejtën gazetareske të paditëses."

Paditësja, në këtë rast gazetarja Natasha Stojanovska, padia e së cilës u refuzua nga gjykata, thekson se kur krahasohen sulmet ndaj gazetarëve me ato të politikanëve, shihet qartë që ekzistojnë standarde të dyfishta te institucionet.

"Sepse, pikërisht në këtë rast, për ndërhyrjen e organizuar në Parlament më 27 prill, për sulmet ndaj politikanëve, prokuroria filloi procedurat sipas detyrës zyrtare, për të cilat u shqiptuan edhe dënime me burg për qytetarët, ndërsa ne, gazetarët, jemi lënë që vetëm të iniciojmë procese gjyqësore private. Kjo është, lirisht mund të them, një padrejtësi që i tregon standardet e dyfishta të institucioneve."

Stojanovska shton: "Si gazetare, unë isha gjithashtu e pranishme edhe në ngjarjet e 24 dhjetorit, kur u miratua buxheti i vitit 2013 në Parlament dhe kur deputetët nga opozita e atëhershme e udhëhequr nga LSDM u rrahën dhe gazetarët u nxorën jashtë me forcë në mënyrë që të mos mundnin të ndjekin seancën dhe të raportojnë për ngjarjet. Në atë kohë, gjykatat vendase nuk konsideruan se e drejta jonë për lirinë e shprehjes ishte e shkelur, por gjykata e Strasburgut vendosi ndryshe. Shpresoja që gjyqësori ynë kishte mësuar leksionin."

RASTI 2: DUSHICA MRGJA DHE GJYKATA THEMELORE CIVILE - SHKUP

Padia është refuzuar – Strasburgu mbetet instanca e fundit për të fituar drejtësi?

"Për gjykatën është e njohur se paditësja si gazetare gjatë ngjarjeve dhe në periudhën pas tyre raportonte për ngjarjet dhe ka shprehur mendimet e saj për ngjarjet e 27.04.2017 në emisione debatuese dhe forume të ndryshme. Kjo do të thotë që në rastin konkret nuk ka shkelje të së drejtës së lirisë së shprehjes, dhe për këtë arsye gjykata e refuzoi padinë plotësisht si e paarsyetuar."

Më 24 nëntor, viti 2020, në emër të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gjykata Themelore Civile - Shkup, përmes gjyqtares **Antoaneta Dimovska**, sjellë një Aktgjykim, duke refuzuar padinë e gazetares Dushica Mrgja si e paarsyetuar.

Në arsyetimin e gjykatës thuhet se:
"Për frikën që paditësja ka vuajtur dhe e cila është e padiskutueshme për gjykatën, i pandehuri nuk është i detyruar të paguajë kompensim për dëmin jopasuror sepse në dispozitën ligjore përcaktohen arsyet mbi të cilat duhet të paguhet dëmshpërblim, dhe frika si e tillë nuk është e përfshirë në dispozitën. Për gjykatën, frika e tillë në mungesë të lëndimit trupor është juridikisht e pranueshme për kompensimin e dëmit jopasuror, por vetëm nga personat që e kanë shkaktuar atë, domethënë nga personat që kanë shkaktuar dhunën. Kjo rrjedh qartë nga vetë dispozita që shteti është i detyruar të paguajë kompensim për lëndimet trupore, për të cilat, nga ana tjetër, neni 189 paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit parashikon:

1. **Në rast të shkeljes së të drejtave personale, gjykata, nëse konstaton se rëndësia e shkeljes dhe rrethanat e lëndës e justifikojnë atë, do të japë një kompensim monetar të zbatueshëm, pavarësisht nga kompensimi i dëmit material, si dhe në mungesë të tij.**

2. **Gjatë vendosjes për kërkesën për kompensim monetar të zbatueshëm, gjykata do të marrë parasysh forcën dhe kohëzgjatjen e dëmtimit që ka shkaktuar dhimbje fizike, dhimbje mendore dhe frikë, si dhe qëllimin për të cilin shërben kompensimi, por gjithashtu edhe për atë që kompensimi të mos jetë në kundërshtim me aspiratat që janë të papërshtatshme me natyrën e tij dhe qëllimin shoqëror.**

Këto janë vetëm disa nga shpjegimet në aktgjykimin me të cilin refuzohet padia e gazetares Dushica Mrgja, e cila gjatë "të enjtes së përgjakshme" ishte në mesin e gazetarëve në Kuvend dhe raportonte për ndërhyrjen në Parlament, dhe jeta e të cilës ishte po aq e rrezikuar si ajo e politikanëve. Ky vendim i gjykatës për gazetaren Dushica Mrgja është i turpshëm.

"Gjykata, ose më saktë gjyqtarja Antoaneta Dimovska mbeti "e verbër" para një ngjarjeje që u pa drejtpërdrejt nga tërë Maqedonia më 27 prill, viti 2017." "E enjtja e përg-

jakshme" është një ngjarje në të cilën shteti, institucionet, Ministria e Punëve të Brendshme dhe policia me orë të tëra nuk lëvizën me gisht përderisa të gjithë ne në qendrën parlamentare të shtypit po përjetonim një torturë. "E enjtja e përgjakshme" është gjakderdhje, për të cilën ka njerëz të dënuar me burg dhe, sipas Prokurorisë Publike, organizatorët e kësaj ngjarjeje janë duke u gjykuar. Disa prej tyre, absolutisht në atë kohë, ishin ndër njerëzit e parë në shtetin dhe institucionet, por për gjykatën dhe për gjykatësen Antoaneta Dimovska kjo nuk ishte e mjaftueshme për të parë që shteti as nuk na mbronte as nuk na lejonte të bënim punën tonë. Justicia është e verbër nga turpi! Unë nuk jam e zhgënjyer sepse kam qenë pjesë e jetës shoqërore të këtij vendi mjaft kohë, dhe sinqerisht, asgjë nuk më habit apo nuk më zhgënjen më. Por, jam shumë e revoltuar! Për shkak të faktit se "e enjtja e përgjakshme" është një nga ngjarjet më të turpshme në demokracinë maqedonase, siç duan ta quajnë politikanët tonë dhe për shkak se në "të enjten e përgjakshme", ky vend preku fundin, por edhe për shkak se nga 28 prilli kishte një shans të papërsëritshme të fillojë të ngrihet nga këneta maqedonase, e cila zgjat gati 30 vjet, sepse "e enjtja e përgjakshme" nuk duhej të ishte një mjet për tregti politike, pazarllëqe, privilegji, amnisti, sepse të gjithë ne që ishim në atë qendër për shtyp gjatë "të enjtes së përgjakshme" lamë aty një pjesë nga vetja jonë. Kjo është arsyeja pse shteti na ka borxh drejtësinë që të mos kemi turp nga vendi ku jetojmë."

Në lidhje me pjesën e padisë për kërkim të dëmit jopasuror për shkak të shkeljes së lirisë së shprehjes, gjykata konstatoi se ajo ishte e pabazuar, si dhe sipas asaj që thuhet në shpjegimin e aktgjykimit, të cilin ne e lexuam, duke cituar nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në një pjesë të shpjegimit shkruan:
"Në këtë rast konkret bëhet fjalë për një akt dhune, në të cilin shteti ka detyrimin të kujdeset për shëndetin, jetën dhe pasurinë e të gjithë individëve dhe personave juridikë. Nuk mund të diskutohet për atë se shteti nuk u ka lejuar të gjithë njerëzve të shprehin mendimet dhe idetë e tyre pa frikë. Interpretimi i Nenit 10 që në rrethana kur ndodhin akte të dhunës, në të cilat paditësja si gazetare është penguar gjatë raportimit, është një interpretim i dispozitës jashtë qëllimit të saj të synuar. Gjegjësisht, ajo rregullon mundësinë që secili të shprehë mendimin e tij në jetën e përditshme, por jo në një situatë ku detyra themelore është mbrojtja e jetës dhe pasurisë së të gjithë personave."

Përkundër këtij vendimi të Gjykatës Themelore Civile - Shkup, paditësja, përkatësisht gazetarja Dushica Mrgja ka vendosur të vazhdojë të kërkojë drejtësinë. Si në shumë raste, nëse kjo nuk do ndodh në vend, destinacioni përfundimtar do të jetë Strasburgu.

"Ata që më njohin e dinë që as nuk fal e as nuk harroj, aq më pak që heq dorë. Do të ketë drejtësi për 27 prillin! Tani e ka rendin Gjykata e Apelit për të vendosur për ankesën time, kështu që unë jam shumë e interesuar nëse gjykatësit e apelit do të fillojnë të shohin, aty ku kolegët e tyre në Gjykatën e Shkupit II i mbyllën sytë, dhe nëse ata u bashkëngjiten, atëherë absolutisht Strasburgu është opsioni i radhës. Aty respektohen të drejtat e njeriut dhe të drejtat e gazetrëve. Si shteti ashtu edhe gjykatësit në

Maqedoni e kanë mësuar atë mësim shumë herë, por ata assesi ta mësojnë atë. Selektivitet absolut, mosinteresim absolut, padrejtësi absolute. Unë kam qenë ndër të parët që kam dëshmuar për "të enjten e përgjakshme", unë jam dëshmitare e të njëjtës prokurori në dy procese gjyqësore për 27 prillin, e përmendur edhe në aktgjykimet. Unë dhe familja ime përjetuam një traumë të trefishtë nga "e enjtja e përgjakshme" dhe përsëritjen e ngjarjeve, por kur erdhi koha që unë të merrja drejtësi, prokuroria maqedonase harroi që unë ekzistoj, dhe gjykatësit maqedonas u bënin sikur nuk ishin nga këtu. Sulmuesi im, për hir të Zotit, nuk është as i identifikuar qe 3 vjet e gjysmë, çfarë të flasim më shumë. Por kur erdhi puna për politikanët, askush nuk u kursye për të qenë ato të kënaqur, qoftë me dënime për dhunuesit, qoftë me amnisti për ata që lejuan që të ndodh kjo, nuk ka shtet. Maqedonia me drejtësinë e saj (jo)selektive për "të enjten e përgjakshme" dëshmoi që ende është larg për tu karakterizuar si shtet."

Për më tepër, në vendimin e gjykatës thuhet se gazetarja Dushica Mrgja, duke vazhduar të raportojë edhe pas ngjarjes së ndërhyrjes në Parlament, domethënë në ditët në vijim, ishte provë për gjykatën se nuk kishte shkelje të së drejtës së shprehjes. Në aktgjykimin shkruan:
"Në fakt, është e padiskutueshme dhe është e njohur për gjykatën se paditësja si gazetare, si gjatë ngjarjeve ashtu edhe në periudhën pas tyre, ka raportuar për ngjarjet dhe ka shprehur mendimet e saj për ngjarjet e 27.04.2017 në emisionet debatuese dhe në forume të ngjashme. Kjo do të thotë që në lëndën konkrete nuk ka shkelje të së drejtës për lirinë e shprehjes, prandaj gjykata e refuzoi padinë plotësisht si të pabazuar."

Përderisa gazetarët kërkojnë drejtësi, gazetarja Dushica Mrgja beson se sulmet ndaj gazetarëve duhet të trajtohen sipas detyrës zyrtare, gjë që tregon faktin se ka standarde të dyfishta kur bëhet fjalë për politikanët dhe gazetarët në pjesën e mbrojtjes dhe sigurisë.

"Gazetarët nga "e enjtja e përgjakshme" janë më meritorët që "e enjtja e përgjakshme" nuk përfundoi edhe më e përgjakshme e me më shumë viktima. Unë ju siguroj se është kështu. Unë e dija që sa më shumë të isha në ajër, aq më të mëdha ishin shanset që çmenduria të mbaronte sa më shpejt, ndërsa policia dhe institucionet të zgjoheshin. Dhe 27 prilli është vetëm një nga shumë ngjarjet e zeza që nga pavarësia e Maqedonisë, për të cilat gazetarët ishin kyçë për të mos qenë këto ngjarje edhe më të errët. Dhe është koha, në fakt është shumë vonë, por më mirë ndonjëherë se kurrë, që sulmet ndaj gazetarëve të ndiqen sipas detyrës zyrtare, sepse gazetarët, ata të vërtetët, janë një nga shtyllat kryesore për një demokraci, pavarësisht se sa elitat politike, të gjitha pa përjashtim, duan ta mohojnë ose thjesht të deklarojnë se nuk është kështu."

RASTI 3: GORAN TRPENOSKI DHE GJYKATA THEMELORE CIVILE - SHKUP

Zyra e avokatit të shtetit nuk pranon se Trpenoski është gazetar?!

Në serinë e proceseve gjyqësore kundër shtetit, dhe në rastin e 27 prillit, i njohur për publikun si "e enjtja e përgjakshme", është edhe gazetari **Goran Trpenoski**. Në ditën e ndërhyrjes së turmës së qytetarëve në Kuvend, Trpenoski është në detyrë të punës - ai raporton për ngjarjet në Parlament. Më 29 prill, viti 2020, në Gjykatën Themelore Civile - Shkup, gazetari ngriti një padi kundër shtetit, në emër të dëmit jopasuror për shkak të frikës dhe dhimbjes shpirtërore, si dhe shkeljes së lirisë së shprehjes.

Pothuajse tre muaj pas paraqitjes së padisë, gazetari Goran Trpenoski po përballet me murin mbrojtës të shtetit, pra institucioneve. Institucioni i Avokaturës së Shtetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut është i pari që flet, duke dërguar në Gjykatën Themelore Civile - Shkup përgjigje për padinë të ngritur nga një përfaqësues ligjor i të pandehurit në lëndën e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në përgjigjen e padisë, përfaqësuesi ligjor i të pandehurit në gjykatë ngriti një kundërshtim për vjetërsimin e padisë dhe prandaj i propozoi gjykatës që të refuzojë padinë. Gjithashtu, Zyra e Avokatit të Shtetit dërgoi kundërshtim për mungesën e legjitimacionit aktiv të paditësit, domethënë gazetari Goran Trpenoski.

Në padinë e ngritur nga gazetari Goran Trpenoski, ai deklaron se ka qenë prezent në Parlament si gazetar i internet portalit www.sakamdakazam.mk. Për Avokaturën e Shtetit, është e diskutueshme që gazetari Goran Trpenoski është në Parlament për të raportuar, ndërsa në padinë e tij nuk ka paraqitur provë se ai është një gazetar i akreditauar në portalin www.sakamdakazam.mk.

Nga shqyrtimi i kërkesës së Zyrës së Avokaturës së Shtetit deri tek gjykata për të refuzuar padinë, kemi vërejtur se në të thuhet:

"Pretendime të tilla të ngritura në padinë janë të pabazuara dhe paushallë, duke qenë se ato nuk kanë kurrfarë mbështetje në provat e bashkangjitura në padinë. Gjegjësisht, në padinë nuk ka asnjë provë që paditësi ka qenë i dërguar në Kuvend për të raportuar, dhe nuk ka provë që ai ka qenë gazetar i akreditauar i internet portalit www.sakamdakazam.mk dhe se paditësi si pjesë e këtij mediumi, atë ditë dhe në momentin kritik kur u bë ndërhyrja në Parlamentin e Republikës së Maqedonisë, ai ka qenë i pranishëm në vendin e ngjarjes. Kjo, duke marrë parasysh që nuk ishte dorëzuar asnjë provë në padinë se redaksioni, domethënë paditësi si pjesë e redaksisë ka pasur urdhër për të qenë prezent në ngjarjen për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë. Gjithashtu, në padinë nuk është dokumentuar as akreditimi për internet portalin e lartpërmendur që ai kishte leje më 27.04.2017 të jetë prezent në konferencat për shtyp, si dhe gjatë zgjedhjes së Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë."

Në bazë të kërkesave të tilla të Avokaturës së Shtetit, gazetari Goran Trpenoski thotë se ai ishte vënë në situatë ku ai duhet t'i dëshmojë gjykatës që ai është gazetar.

"Pas 19 vitesh punë si gazetar, redaktor i rubrikës politike dhe raportues nga parlamenti, unë dëshmoj para Gjykatës se jam gazetar dhe se më 27 prill në Parlament kam qenë zyrtarisht i pranishëm për të bërë punën time në mënyrë profesionale. Për Gjykatën, është e diskutueshme që kam punuar për një portal, i cili nuk mund të konsiderohet si medium. Është absurde që pas 19 vjetësh duhet t'i dëshmoj gjykatës që unë me të vërtet jam gazetar, kush më ka dërguar Parlament, pse kam qenë aty, nëse "Sakamdakazam" është medium apo jo. Ky medium në Regjistrin Qendror është regjistruar si një gazetë digjitale, dhe jo si një portal."

Sidoqoftë, përveç kësaj, Zyra e Avokaturës të Shtetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut kërkon nga gjykata që të refuzojë padinë e gazetarit Goran Trpenoski sepse nuk kishte prova për atë se kur gazetari është larguar nga Kuvendi. Në kërkesën e këtij institucioni thuhet:

"Duke pasur parasysh të gjitha rrethanat, në rastin konkret nga provat e paraqitura në padi, nuk mund të përcaktohet se më 27.04.2017, kur u bë ndërhyrja në Parlamentin e RMV, paditësi ishte zyrtarisht i pranishëm në ngjarjen, dhe kjo është arsyeja pse ne propozojmë të refuzohet padia për shkak të mungesës së identifikimit aktiv."

Gazetari Goran Trpenoski, i cili është sjellë në pozicion të dëshmojë punën e tij të gjatë në gazetarinë dhe integritetin, beson se gjatë "të enjtes së përgjakshme" forca e shtatë luajti një rol kryesor në ngjarjet dhe parandaloi përshkallëzimin e tyre.

"Përveç gjithë dokumentacionit të nevojshëm, i cili vërteton përvojën time në gazetari, unë dorëzova plotë video dhe fotografi, të cilat dokumentojnë gjithçka që ndodhi gjatë sulmit të organizuar ndaj Kuvendit prapa dyerve të parlamentit. Sa herë që dikush më kujton ato ngjarje, unë shqetësohem, imazhet e kokës së përgjakshme të **Zoran Zaevit**, deputetëve të lënduar, gazetarëve, por edhe të plagëve të rënda të **Zijadin Selës** nuk zbehen."

Zyra e Avokaturës së Shtetit të Republikës së Maqedonisë thotë me vendosmëri: "Ne e kontestojmë pretendimin e paditësit në tërësi dhe propozojmë që ajo të refuzohet si e pabazë", në arsyet e kërkesave të tilla thuhet se:

"Në padinë nuk është theksuar kur paditësi është nisur për në Parlamentin e RMV, si dhe kur është larguar nga aty. Paditësi deklaron se në situatën e krijuar ai ende është gjind në qendrën për shtyp, si dhe se ai ishte në murin e gjallë, i cili nuk lejonte njerëzit të hynin dhe të sulmonin gazetarët dhe deputetët. Pretendimet e tilla në padinë janë të pabazuara dhe paushallë, duke qenë se ato nuk kanë asnjë mbështetje në provat e bashkangjitura në padinë. Duke pasur parasysh të gjitha gjërat, në rastin konkret, nga provat e paraqitura në padi, nuk mund të përcaktohet se më 27.04.2017, kur u bë ndërhyrja në Parlamentin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, paditësi ishte zyrtarisht i pranishëm në ngjarje. Prandaj, meqenëse paditësi nuk dëshmoi që ai ishte i pranishëm në kohën kritike, ne konsiderojmë që padia duhet të refuzohet si e pabazuar."

Gazetari Goran Trpenoski, profesioni i të cilit kontestohet nga Zyra e Avokaturës së Shtetit për shkak të mungesës së akreditimit, dhe në kontekstin e asaj që thuhet në pjesën e provave, pretendon se ai ishte në mburojën e gjallë, ku ka luftuar për të mbrojtur jetën e politikanëve.

"Po të mos ishim aty, historia do të kishte qenë ndryshe. Do të kishte njerëz të vdekur. Ne parandaluam përshkallëzimin e ngjarjeve, e bëmë punën tonë në mënyrën më profesionale. Unë madje isha në mburojën e gjallë, duke mbrojtur jetën e politikanëve dhe tani është e diskutueshme nëse jam një gazetar apo jo. Turp për shtetin dhe gjyqësorin. Dhe pastaj dikush tjetër është fajtor që institucionet ndërkombëtare na vendosin në grupin e shteteve me regjim hibrid dhe jemi në vendin e 111-të për luftë kundër korrupsionit. Unë nuk do të dorëzohem, e di se cili do të jetë epilogu, por kjo punë do të shkojë deri në gjykatën në Strasburg. Duhet të ketë përgjegjësi. Askush nuk u dënua për dëbimin brutal të gazetarëve dhe deputetëve nga Parlamenti në vitin 2012. Gjyqësori dhe prokuroria, duke pastruar "27 prillin", mund të dëshmojnë se sundimi i ligjit nuk ka vdekur në vend. Tani për tani, kjo tregon se sistemi gjyqësor ka nevojë për ndryshime të mëdha."

SHGM: Gazetarët nga 27 prilli janë viktima për herë të dytë, këtë herë janë viktima të gjykatës

"SHGM do t'i informojë të gjitha organizatat relevante ndërkombëtare në lidhje me këtë vendim të turpshëm në dëm të gazetarëve dhe lirisë së shprehjes në vendin tonë."

Gjykata Themelore Civile në Shkup solli vendime me të cilët refuzohen paditë e gazetareve Natasha Stojanovska dhe Dushica Mrgja, të cilët kërkuan shkelje të të drejtave të tyre dhe dëmtime nga shteti për ngjarjet e 27 prillit, viti 2017, në Parlamentin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Ky vendim është një mundësi e humbur për të mbrojtur të drejtat e gazetarëve dhe paraqet edhe një provë tjetër që për gjykatën ka standarde të dyfishta, kur bëhet fjalë për politikanët dhe gazetarët. Ju kujtojmë se në rastin e grupit të politikanëve, Prokuroria Themelore Publike, sipas detyrës zyrtare, filloi procedurat dhe Gjykata Penale dënoi

një grup qytetarësh me burg, ndërsa në rastin e gazetarëve ata u lanë të ngrejnë padi private.

Arsyetimi i gjykatës në vendimet është se gazetarët nuk kanë paraqitur prova nga të cilat mund të përcaktohet se më 27 prill të vitit 2017 kishte demonstrata publike para Parlamentit, edhe pse në padinë janë paraqitur video incizime nga ngjarjet që ndodhën para Kuvendit, ndërsa në ditën kritike, qindra lajme dhe publikime kishte në mediat. Fakti që gjykata nuk njeh shkelje të së drejtës së lirisë së shprehjes dhe u kërkon gazetarëve të dëshmojnë fakte të njohura se ka pasur një ndërhyrje në Kuvend nga persona që demonstruan publikisht më 27 prill, viti 2017, është tendencioz dhe krijon një precedent në kontekstin e kësaj lënde.

Ministri i Drejtësisë, **Bojan Mariçiq**, gjatë paraqitjes së tij në emisionin Analiza në TV 24[4], nuk dëshironte të komentonte për këto raste, as vendimin e gjykatës, e as pozicionin e Avokaturës së Shtetit. Sidoqoftë, ministri, nga i cili shoqatat gazetareske kërkojnë ndryshime në Kodin Penal, kur bëhet fjalë për procedurat për gazetarët, nënvizoi se ai është solidarizuar me gazetarët, në lidhje me vendimet e gjykatës që hedhin poshtë paditë e gazetarëve për "të enjten e përgjakshme."

"Si do të zgjidhen këto vendime në të ardhmen, sigurisht që do të vijojë një procedurë në Gjykatën e Apelit, që do të thotë se sistemi ka ende shansa për të zgjidhur këtë, nëse jo, ekziston edhe Strasburgu. Së pari, unë mendoj se duhet të ketë një ankesë të gazetarëve në gjykatën më të lartë, sepse gazetarët ishin të dëmtuar në mënyrë të barabartë, si të gjithë të tjerët që ishin në Parlament atë ditë, dhe për këtë nuk kam dyshim. Më vjen keq dhe kam thënë mjaft për këtë rast, që të mos thotë dikush që unë dua të ndikoj, gjykata ende ka mundësi ta rishqyrtojë edhe një herë këtë lëndë."

SHGM konsideron se pretendimi i gjykatës se gazetarët nuk kishin të drejtë të kërkonin kompensim për dëmin jo-material për dhimbjen mendore është i palogjikshëm. Skandaloz është fakti që gjykata nuk e njeh që dhimbja emocionale, frika dhe trauma e përjetuar nga gazetarët e pranishëm në Kuvend është problematike dhe njëkohësisht implikohet që paditësit nuk kanë pasur lëndime trupore.

[4] https://www.youtube.com/watch?v=s21pPAjqnnE&feature=emb_title

VI. INSTITUCIONET DHE GAZETARËT

Qëndrimi i përgjithshëm i gazetarëve dhe gazetareve në këtë publikim është se ekzistojnë standarde të dyfishta në sjelljen e institucioneve, kur bëhet fjalë për politikanët dhe gazetarët. Për të parët, ata mendojnë se institucionet reagojnë shpejtë, ndërsa në rastin e gazetarëve, ata janë lënë vet të udhëheqin betejën për drejtësi dhe siguri më të madhe gjatë punës, që do të thoshte edhe liri më të madhe në qasjen, mbledhjen dhe analizimin e informatave kyçe në krijimin e opinionit publik. E gjithë kjo tregon nevojën për të ndryshuar legjislacionin, përkatësisht nevojën për mbrojtje sistematike të gazetarëve dhe punonjësve mediatik.

Sa për ilustrim, në vitin 2020, gjithsej 14 raste janë regjistruar nga Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë. Për këto raste, Ministria e Punëve të Brendshme, sipas informatave të dërguara, ka vepruar në tetë raste, ndërsa për gjashtë rastet e tjera ato nuk dërguan kurrfarë informata. Në kontekstin e këtyre sulmeve ndaj gazetarëve, vetëm një rast ka përfunduar me aktgjykim, dy raste janë pastruar, ku ata kanë gjetur shkelje sipas nenit 4 dhe nenit 10 të Ligjit për kundërvajtje kundër rendit publik dhe paqes, ndërsa në rastet tjera procedura është akoma në relacionin MPB - PThP - MPB, që do të thotë se asnjë prej tyre nuk ka arritur para gjykatës përkatëse.

Në vitin 2020, Gjykata Penale në Shkup ka regjistruar tre raste, në të cilat palët e dëmtuara janë deklaruar se janë gazetarë me profesion, nga të cilat vetëm njëri rast i referohej rasteve të regjistruara nga SHGM. Bëhet fjalë për rastin e gazetares Meri Jordanovska, ndërsa dy rastet e tjera (K.nr.624/20) i referohen veprës penale Pjesëmarrje në turmë që do të kryejë një vepër penale dhe K.nr.3296/20 për veprën penale Dhunë, dhe në këto lëndë, viktimat pre-

tenduan se ishin gazetarë me profesion, dhe janë akoma lëndë aktive, dhe janë në kontekstin e 27 prillit të njohur për publikun si "e enjtja e përgjakshme."

Kur bëhet fjalë për (mos)veprimin e institucioneve në lidhje me sulmet ndaj gazetarëve, SHGM beson se niveli i mosndëshkimit është ende shumë i lartë. Në raportin e SHGM-së, për sa i përket efikasitetit të sistemit gjyqësor, në mbrojtje të gazetarëve thuhet:

"Për të katërtin vit me radhë, Gjykata Themelore Civile dhe Penale në Shkup nuk është në gjendje të japë informata në lidhje me fazën e procedurave për lëndët në të cilat gazetarët paraqiten si viktima. Arsyetimi i tyre është se sistemi i ri i menaxhimit të lëndëve (AKMIS) bazohet në kode, e jo në emrat dhe profesionet e palëve. Në vitin 2020, vullneti për bashkëpunim i Gjykatës Themelore Civile u zvogëlua dhe ne arritëm të marrim informata vetëm për numrin e përgjithshëm të lëndëve të shpifjes dhe fyerjes, por jo edhe për atë se në sa prej tyre si palë ka një gazetar apo media. Niveli i mosndëshkimi mbetet i lartë dhe vendime gjyqësore ka pasur në më pak se 10 për qind të rasteve të regjistruara. Nuk ka procedura të veçanta për trajtimin e sulmeve ndaj gazetareve në institucione. "Në sistemin gjyqësor-prokurorial në Maqedoni nuk ka departamente të posaçme që punojnë për të hetuar rastet e persekutimit, mbrojtjes dhe kompensimit të gazetarëve, në mënyrë që të sigurojnë sigurinë e tyre dhe të parandalojnë politikën e mosndëshkimit."

Lidhur me vërejtjen se Gjykata Penale në katër vitet e fundit nuk jep informata në lidhje me fazën në të cilën janë lëndët, gjykata u përgjigj se:

"Padyshim që bëhet fjalë por mosinteresim nga ana juaj për punën e gjykatës, duke pasur parasysh se gjykimet janë publike, përveç nëse ka pengesa ligjore për të, dhe përfaqësuesit e medias rregullisht monitorojnë dhe raportojnë mbi gjykimet që janë në interes të publikut. Për të gjitha pyetjet e gazetarëve, gjykata organizon brifingje të rregullta dhe u përgjigjet të gjitha pyetjeve, dhe shpesh ato pyetje janë pikërisht nga Shoqata e Gazetarëve, me të cilën gjykata ka pasur bashkëpunim të shkëlqyeshëm deri më tani."

Sidoqoftë, e gjithë kjo tregon për dobësitë në zgjidhjen institucionale, kur bëhet fjalë për sulmet ndaj gazetarëve. Për të përmirësuar situatën, nevojitet një bashkëpunim i përbashkët, midis shoqatave gazetareske dhe institucioneve kryesore, të cilat duhet t'i marrin me seriozitet më madh sulmet ndaj gazetarëve në përpjekje për t'i zgjidhur ato deri në fund.

Për këtë qëllim, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, në uebinarin e fundit, në të cilin morën pjesë gazetarë, përfaqësues të institucioneve nga radhët e PTHP dhe nga Ministria e Drejtësisë, si dhe avokatë, arriti në përfundimin se vetëm përmes ndryshimeve specifike në Kodin Penal dhe Ligjin për procedurën penale, duke i dhënë kompetenca më të mëdha Prokurorisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme për të vepruar sipas detyrës zyrtare dhe duke rritur dënimet për sulmuesit, do të përmirësohen sistematikisht siguria e gazetarëve dhe politika e mosndëshkimit për sulmet ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik.

Kryetari i Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë, Mlladen Çadikovski, në fjalët hyrëse shprehu pakënaqësinë e tij sepse gjërat janë akoma të ndenjura dhe se reformat janë bllokuar, edhe pse gjatë vitit të fundit disa herë janë përsëritur gjërat që duhet të ndryshohen. “Ende kemi rritje të numrit të sulmeve dhe kërcënimeve verbale ndaj gazetarëve dhe niveli i mosndëshkimit të sulmeve ndaj gazetarëve mbetet i lartë. Do të ishte një sukses i madh, në vend që sulmet ndaj gazetarëve të ishin rregull, ato të bëhen incidente të cilët do të dënohen.”

Prokurorja themelore publike **Spasenka Andonova**, si një nga panelistet, në fjalimin e saj drejtuar pjesëmarrësve të uebinarit theksoi se si përfaqësuese e prokurorisë, ata janë të detyruar të respektojnë legjislacionin. Ajo theksoi gjuhën e urrejtjes si shembull të komunikimit me elementë diskriminuese, e cila përdoret shpesh kundër gazetarëve dhe punonjësve mediatik.

Ajo theksoi se, për fat të keq, numri i paraqitjeve për gazetarët e dëmtuar është një proces që shënon rritje. Përballë një numri kritikash drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Prokurorisë, për veprimin e pamjaftueshëm në lidhje me hetimin dhe mosvendosjen e lëndëve në gjykata, ajo tha se prokurori publik nuk duhet të shkojë përtej legjislacionit që i imponohet. Paraqitja e rasteve në prokurori është vetëm akti fillestar, i cili, në fakt, fillon punën dhe veprimet e prokurorit publik.

Sa më shumë paraqitje që përmbajnë informata konkrete, aq më tepër do të shkurtohet koha e procedurës së mbledhjes dhe hetimit. Ajo theksoi mbështetjen e këtij procesi në procesin e përmirësimit të legjislacionit duke përdorur përvojat nga ndryshimet e mëparshme në KP për të dhënë formë dhe përmbajtje për veprim më efikas dhe efektiv të Prokurorisë Publike në procedurat për mbrojtjen e sigurisë së gazetarëve.

Avokati **Ivan Breshkovski** theksoi se është e rëndësishme që prokuroria të marrë masa zyrtare. Krimi i dhunshëm, tortura ndaj gazetarëve, kanë një motiv tjetër në krahasim me krimin e zakonshëm. Është e rëndësishme të provohet motivi i krimit për të vepruar prokuroria.

“Është e nevojshme të shtrëngohen dënimet ose të futet një formë më e madhe e veprës penale në mënyrë që të fitohet mbrojtje më e madhe për avokatët në Kodin Penal. Një problem tjetër që duhet theksuar është kur bëhet fjalë për kërcënime në internet, të kushtohet vëmendje nëse kërcënimet vijnë nga zyrtarë partiak apo zyrtarë të shtetit. Në ato raste prokuroria duhet të fillojë veprimet zyrtare. Në kohë të fundit mund të vërehet se gjithnjë e më shumë gazetaret janë viktima të kërcënimeve. Duhet të bëhet një thirrje inkurajuese për gazetaret se ka gjithnjë e më shumë fonde që mund të mbulojnë kostot dhe gazetarët tani mund të ngritin padi më lehtë në krahasim me të kaluarën.”

Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë përkujton se gjyqësori ka për obligim të mbrojë të drejtat e gazetarëve sepse me atë mbron edhe të drejtën e qytetarëve për tu informuar.

QËNDRIM INTEGRAL I MPB-SË NË LIDHJE ME SULMET NDAJ GAZETARËVE DHE PUNONJËSVE MEDIATIK

Ne, në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në vitet e fundit kemi bërë një përparim të madh në këtë fushë dhe situatën para vitit 2017, kur gazetarët ishin një shënjestër e shpeshtë e dhunuesve, dhe shpesh e policisë, sulme që shpesh shkonin të pazgjidhura, ose pa dënim për dhunuesit, për të arritur në një situatë ku sulmet ndaj gazetarëve janë të rralla. Sigurisht, kjo kërkonte, mbi të gjitha, vullnet politik dhe shumë punë. Duhet të theksoj rolin e Misionit të OSBE-së në Shkup dhe Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë, me të cilët kemi punuar së bashku në këtë fushë gjatë viteve të fundit dhe kemi arritur një rezultat me të cilin ne si Ministri e Punëve të Brendshme jemi krenarë dhe për këtë kemi mirënjohje nga gazetarët dhe organizatat gazetareske. Ky progres u theksua edhe në raportin e Komisionit Evropian, gjë me të cilën krenohemi. Sigurisht që gjithmonë ka vend për tu përmirësuar dhe ne do të vazhdojmë të punojmë në këtë fushë edhe në të ardhmen.

Pikërisht qëndrimi i tillë kontribuoi në zvogëlimin drastik të numrit të sulmeve të tilla, të cilat janë zvogëluar në minimum. Fatkeqësisht, në gjysmën e parë të vitit 2020, në periudhën e të ashtuquajturës qeveri teknike, kur kishte ndryshim në udhëheqjen e Ministrisë së Punëve të Brendshme, patëm një përkeqësim të lehtë, por tani gjërat janë kthyer në normalitet dhe ne vazhdojmë në drejtimin e duhur.

Dhe për të arritur rezultate të tilla u desh një përpjekje e madhe. Së pari, e bëmë Ministrinë e Punëve të Brendshme të hapur për gazetarët, nënshkruam një memorandum bashkëpunimi me Shoqatën e Gazetarëve dhe me bash-

këpunimin e përbashkët u përqendruam në përmirësimin e situatës. Unë, si Ndihmës-Ministër për marrëdhënie me publikun, u emërova gjithashtu si personi përgjegjës për përgjigjen e menjëhershme ndaj çdo problemi që kanë gazetarët. Nga tejkalimi i problemeve për atë se ku dhe kur punonjësit mediatik mund të xhirojnë, sepse në atë periudhë gazetarët dhe policia shiheshin si armiq në mes vete, e deri te ndonjë sulm fizik.

Në bashkëpunim me Misionin e OSBE-së dhe Shoqatën e Gazetarëve të Maqedonisë, përgatitëm dhe botuam një "Doracak për sigurinë e gazetarëve gjatë ngjarjeve me rrezik të lartë" që të përmirësojmë në mënyrë drastike dhe cilësore situatën në fushën e zbatimit të profesionit të gazetarisë në mënyrë sa më të sigurt. Doracaku, kishte për qëllim të shërbejë për identifikimin e rreziqeve dhe shmangien e sulmeve ndaj gazetarëve, veçanërisht gjatë raportimit nga ngjarjet që janë me rrezik të lartë. Gjithashtu, kishte për qëllim t'i sqarojë procedurat dhe kompetencat ligjore të Ministrisë së Punëve të Brendshme, por edhe të Prokurorisë Publike, në mënyrë që të sigurohet mbrojtje më e madhe e gazetarëve.

Zhvillimi i këtij doracaku u parapri nga gjashtë punëtori me temë "Siguria e gazetarëve gjatë raportimit nga ngjarjet me rrezik të lartë, liria e shprehjes dhe përmirësimi i komunikimit midis gazetarëve dhe policisë." Gazetarë, foto-reporterë, si dhe pjesëtarë të Ministrisë së Punëve të Brendshme morën pjesë në këto trajnime, në të cilat u ndanë përvojat dhe u caktuan pikat ku mund të përmirësohet bashkëpunimi i ndërsjellët. Këto punëtori kontribuuan shumë në njohjen e njëri-tjetrit dhe në tejkalimin e pengesave midis gazetarëve dhe policisë.

Një nga detyrat kryesore të institucioneve të sistemit, gjegjësisht atyre që u është dhënë mandati për të sunduar, është që vazhdimisht të punojnë në krijimin e një ambienti cilësor për arritjen e të gjitha kushteve të rëndësishme për funksionimin e mediave, të komunikojnë dhe të bashkëpunojnë me mediat. Interesi, përkatësisht përfitimi është i përbashkët dhe i shumanshëm: si për mediat, gazetarët dhe institucionet, ashtu edhe për publikun dhe qytetarët.

Rrjedhimisht, ne jemi të detyruar që të bashkëpunojmë, të ndërtojmë në mënyrë të vazhdueshme marrëdhëniet dhe komunikimin, i cili do të mundësojë prezantim cilësor dhe të saktë, të aktiviteteve tona, por do të kontribuojë edhe për kryerje të papenguar dhe të sigurt të profesionit të gazetarisë. Pa kërcënime, pa dhunë, dhe pa asnjë pengesë që do të ishte problem për cilin do medium apo gazetar. Ne, si Ministri për Punët e Brendshme, së bashku me partnerët tanë, vazhdojmë të punojmë në këtë fushë edhe në të ardhmen, në mënyrë që të arrijmë rezultate edhe më të mira.

Sa i përket ndryshimit të legjislacionit, ne nuk kemi kompetenca, por mbështesim ndryshime të tilla, dhe, sipas informatave që i kemi nga institucionet e tjera, tashmë janë duke u ndërmarrë hapa në këtë drejtim.

VIII. QËNDRIMI INTEGRAL I PTHP NË LIDHJE ME SULMET NDAJ GAZETARËVE DHE PUNONJËSVE MEDIATIK

"Analizat e Prokurorisë Publike tregojnë se në këtë moment nuk ka nevojë për krijimin e një njësie të specializuar për trajtimin e veprave penale kundër përfaqësuesve të mediave."

Pas paraqitjes së pranuar, Prokuroria mbledh prova materiale dhe verbale për të ndjekur penalisht autorët e krimeve. Në këtë mënyrë, Prokuroria Publike, në të gjitha rastet, përfshirë edhe ato që lidhen me sulmet ndaj gazetarëve, vepron në mënyrë efikase dhe me përgjegjësi, me dinamikën e nevojshme për të siguruar të gjitha provat e rëndësishme për përcaktimin e situatës faktike dhe përgjegjësisë penale. Ajo që mund të nxisë perceptimin e përpunimit të ngadaltë të këtyre lëndëve, është ndoshta fakti se shumë prej sulmeve ndaj gazetarëve nuk raportohen fare në Prokurorinë Publike, nga prokuroria pritet të reagojë sipas zërit të prekur, gjë që e ndërlikon procedurën e mbledhjes së provave. Gjegjësisht, nuk është e lehtë të ndiqet dikush për sulm ndaj një personi të caktuar (qoftë një gazetar apo jo), nëse viktima nuk është e gatshme të mbështesë ndjekjen penale duke dhënë dëshmi personale.

Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut kishte disa takime pune me përfaqësues të Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë. Analizat e Prokurorisë Publike tregojnë se në këtë moment nuk ka nevojë për krijimin e një njësie të specializuar për trajtimin e veprave penale të kryera kundër përfaqësuesve të mediave.

Megjithatë, për të marr masa për veprat penale të kryera kundër përfaqësuesve të mediave, prokuroritë duhet të veprojnë në mënyrë efektive. Në mënyrë që të arrihet kjo, duhet të ketë një bashkëpunim më të ngushtë me shoqatat e gazetarëve, në mënyrë që të zbulohen rastet sa më shpejtë, gjë për të cilën prokuroria është tërësisht e përgatitur.

Lidhur me ndryshimet në Kodin Penal në këtë pjesë, Prokuroria Publike vepron në përputhje me dispozitat aktuale ligjore. Nëse në të ardhmen, ligjvënësi parashikon mbrojtje të veçantë institucionale të gazetarëve duke futur dispozita të reja ose duke ndryshuar nenet ekzistuese në Kodin Penal, atëherë prokuroria do të kryejë ndjekjen penale në përputhje me legjislacionin e ri. Kodi Penal është një materie e gjallë, e cila duhet të azhurnohet vazhdimisht në përputhje me nevojat e trendëve moderne shoqërore dhe tendencave të krimit. Roli i tij kryesor duhet të jetë sanksionimi i autorëve të krimeve, por edhe veprimi parandalues për të luftuar krimin.

IX. REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIMIN E SITUATËS

Nëse i përmbledhim hapat konkretë që mund të ndikojnë në zvogëlimin e trendit të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve, por gjithashtu edhe të zgjidhet sistematikisht problemi me mosndëshkimit, këto janë rekomandimet tona:

- **Futja e masave speciale për mbrojtjen e gazetarëve përmes ndryshimeve në disa prej ligjeve, si zgjidhje sistematike dhe afatgjata.** Si shembull për këto masa mund të jenë ndryshimet dhe plotësimet në Kodin Penal në pjesën që i referohet, mbi të gjitha, rrezikimit të sigurisë, si dhe sulmeve fizike, por edhe gjurmimi, si një akt i ri. Këto ndryshime janë të nevojshme për të siguruar dënime më të larta për autorët e krimeve në rastet kur gazetarët janë viktima dhe sulmohen gjatë kryerjes së detyrave gazetareske profesionale ose si rezultat i tyre, dhe, përveç dënimeve më të larta, Prokuroria Themelore të ndërmarrë aktivitete sipas detyrës zyrtare. Në këtë mënyrë, pritet të përmirësohet politika e mos-

ndëshkimit sepse në vend që gazetarët të ngrenë padi private për dëmtime ose shkelje të ligjit, prokuroria do të ndërmarrë veprime të tilla ngjashëm si zgjidhja aktuale në ligjin për mjekët, avokatët etj.

- **Duhet të përmirësohet ndërgjegjja e publikut të gjerë për dëmet që shkaktohen si pasojë e mosndëshkimit, si dhe shkeljen e sigurisë së gazetarëve, gjë që mund të ndikojë negativisht në cilësinë e informatave publike,** përmes: fushatave publike nga organizatat e shoqërisë civile në sektorin e mediave, por edhe nga institucionet shtetërore, si dhe dënime publike nga të gjithë aktorët përkatës, veçanërisht nga liderët e partive politike, në rastet e rrezikimit të sigurisë së një gazetari ose mediumi.

- **Nevojiten përpjekje shtesë për një koordinim më të madh ndërmjet institucioneve në rast të kërcënimeve dhe sulmeve, veçanërisht në pjesën e kërcënimeve në internet.** Nga regjistri i sulmeve mund të konkludohet se rrallë ndërmerren masa në rastet kur kërcënimet ndaj gazetarëve janë bërë përmes rrjeteve sociale. Për të korrigjuar këtë, duhet të përmirësohet bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Prokurorisë Publike, por gjithashtu edhe t'i jepen autorizime shtesë Ministrisë së Punëve të Brendshme për të vepruar sipas detyrës zyrtare, në rastet kur rrezikohet siguria e gazetarëve përmes sistemeve kompjuterike , dhe jo të lihet gazetari që t'i kërkojë të drejtat e tij përmes padive private.

- **Mediat duhet të sigurojë pajisje mbrojtëse për gazetarët për të mbuluar ngjarje me rrezik të lartë.** Pajisjet mbrojtëse, të tilla si helmetat, blindat e trupit, mburojat, maskat e gazit, etj., në rastet kur gazetarët raportojnë për protesta të dhunshme, demonstrata, sporte të rrezikshme, etj., duhet të kenë dhe të përdorin pajisje mbrojtëse në mënyrë që të mund të jenë të mbrojtur.

- **Gazetarët duhet t'i dinë të drejtat e tyre, dhe në rast se shkelen të drejtat e tyre, ata duhet të paraqesin rastin tek autoritet ose organizatat përkatëse.** Disa nga sulmet e regjistruara në vitin 2020 nuk janë të paraqitura në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Në këtë mënyrë, mund të ndodh që procedura të mos iniciohet fare nga autoritetet kompetente, veçanërisht kur bëhet fjalë për kërcënime në rrjetet sociale. Prandaj është e nevojshme që gazetarët t'i raportojnë këto incidente në shoqatat e gazetarëve dhe tek autoritetet kompetente, dhe, gjithashtu është e rëndësishme që atyre t'u ofrohet ndihmë juridike falas nga organizatat gazetareske.

- **Ekziston nevoja për trajnim të vazhdueshëm për pjesëtarët e Ministrisë së Punëve të Brendshme, gjykatësve dhe prokurorëve për tema që lidhen me lirinë e shprehjes dhe rolin e gazetarëve dhe mediave në shoqëri.** Këto trajnime duhet të jenë të rregullta dhe të bëhen në bashkëpunim me organizatat e punonjësve mediatik, Akademinë për trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve publik, si dhe shoqatat e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë